



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 14.06.2024

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/LI-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 14.06.2024 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e VI-të (të rregullt) të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **21.06.2024**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e 5-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024.
2. Pyetje legjislativitet drejtuar ekzekutivit.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore (KAB), për Komunën e Kamenicës për vitin 2025-2027.
4. Propozim-Vendim për miratimin e Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2028.
5. Propozim-Vendim për miratim për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Qendresa Gagica Hajdari B.I”, me procedurë të negociimit të ofertës.
6. Propozim-Vendim për miratim për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Veton Kallaba B.I” me procedurë të negociimit të ofertës.
7. Kërkesë nr.17660 nga Kryqi i Kuq i Kosovës dega në Kamenicë.
8. Propozim për nismën për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Ranillugut në fushën e Zjarrëfiksve, Mamografisë dhe Realizimin e Studimit të fizibilitetit për ujë të pijes për Ranillug dhe Petrit.
9. Propozim-Vendim për plotësimin e vendimit bazë nr.7342.
10. Të ndryshme.



Liridon KASTRATI
Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 01 Nr. 19189
U. _____ Br. _____

Nr. i faq. 6 Data: 12/06
Br. str. _____ Datum: _____

KAMENICË/A 2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V-të e Kuvendit të Komunës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës e mbajtur më: 30.05.2024 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, zyra e informimit, përfaqësues të Zyrës për Integritet Evropian, , Koordinatorë e Njësive Komunale për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijëve OJQ dhe OSBE. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 4-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024,
2. Pyetje e legjislativit drejtuar ekzekutivit,
3. Plani i Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali (2024-2026) në Komunën e Kamenicës,
4. Draft-Plani i Veprimit për Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Komunën e Kamenicës (2024-2026)
5. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, para se me filluar konstatohet se kemi kourum të mjaftueshëm për të filluar seancën, a keni propozime për plotësim-ndryshim të rendit të ditës?

Nëse nuk keni unë kam dy propozime

1. Propozim-vendim për hartimin e Hartes Zonale të Komunës se Kamenicës

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite?

Për.....të gjithë

Kundër0

Absntenim.....0

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- propozimi i dytë është:

2. Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Bazë Sh.01 Nr. 1480 i datës:12.05.2022 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, ky vendim ka të bëjë me zëvendësimin e një anëtari pasi që anëtari Fatlum Xhaqku nuk është më në marrëdhënie të punës në komunën tonë dhe i njëjti të zëvendësohet me z. Riad Rahimi.

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite?

Për.....të gjithë

Kundër0

Abshtenim.....0

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj-në një rën nga seancat e kaluar kemi marrë vendim për ndarjen e parcelës për ndërtimin e strehimores për kafshët endacake dhe afër asaj parcelës është një parcelë në pronësi të AKP-së e cila është e nevojshme që të shpallet interes i përgjithshëm në mënyrë që strehimorja të ketë kapacitetin e mjaftueshëm në nivel të regjionit. Propozoj që ky vendim të hyjë në rend dite.

3. Propozim-Vendim për Shpalljen në Interes të Përgjithshëm Publik

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kush është që të hyjë në rend dite Propozim-Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik?

Për.....të gjithë

Kundër0

Abshtenim.....0

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kush është për miratimin e rendit të ditës?

Për.....të gjithë

Kundër0

Abshtenim.....0

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 4-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-a keni diskutime për pikën e parë të rendit të ditës, nëse jo e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e pikës së parë?

Për.....të gjithë

Kundër0

Abshtenim.....0

2. Pyetje e legjislativit drejtuar ekzekutivit,

Magbule Kastrati- për cilën pjesë të komunës bëhet fjalë kjo pronë?

Egzona Zuzaku-Isufi- Shqetësim tjetër është se në fshatin Busavatë në SHFMU " Hasan Prishtina " ku banorët pohojnë se nëntë nxënës të klasës së katërt ka mbi 6 muaj që janë pa mësim pasi që mësuesja Arlinda Demolli, shkon në pushim të lindjes dhe nuk zëvendësohet me mësuese tjetër për gjashtë muaj , njëashtu edhe klasa e tretë nuk mban mësim afër 3 javë pasi mësuesja Qefserë Haxhiu gjithashtu gjindet në pushim të lindjes. Sipas disa informacioneve ju kryetar nuk ishtit në dijeni, kurse drejtori ka thënë se nuk po guxon se nuk po e dëgjojnë! Ju jeni thirr gjatë gjithë kohës për mbajtje të mësimin dhe kundër reformës dhe tani cila reform po mbetet, reforma keqeverisje apo ju? Sipas një informacioni tjetër thuhet se stafi menaxhues i shkollës specifikisht drejtori e ka përsëritur vitin disa herë në klasën e gjashtë, a mundeni me na treguar cila e vërtet qëndron në fshatin Busavatë?

Jeton Biqkaj-kisha një kërkesë lidhur me infrastrukturën tek memoriali " Mulla Idrizi" mundësisht të rregullohet ngas enuk ka asnjë efekt nëse nuk ka infrastrukturë kot investohet nga ministria e infrastrukturës. Tjetra është se vitin e kaluar ka qenë temë trotuari në lagjen " Iliria", rrethojat që janë vendos tek bimët duken se janë ndryshkuna dhe japin një pasqyrë të keqe dhe nuk e di se çfarë materiali mund të kenë a ka ndonjë garancion apo jo. Pyetje tjetër është se deri ku ka arritën puna e sheshit është viti i 5-të që ne ende kemi një shesh të papërfunduar ajo krijon një pengesë edhe për qytetarët, bizneset. Po ashtu në media kemi parë edhe qështjen e presionit ndaj punëtorëve në administratën komunale siç është rasti në drejtorin e kulturës që mënyra dhe sjellja e udhëheqësve se si sillen ndaj zyrtarëve e që nuk është i vetëm ky rast i vetëm i administratës.

Shpresa Shala Sermaxhaj-pas komunikimit që kemi pasur me semimaturatët shumica prej tyre nuk kanë interes me u regjistruar në shkollat e Kamenicës, sigurisht për shkak të mungesës së drejtimit me perspektivë si: mjekësia, infermiera apo të ketë edhe bursa për nxënësit që regjistrohen në shkollat e mesme të Kamenicës. Kryetar keni deklaruar se do të ndani bursa për studentët që do të regjistrohen në Universitetin " Kadri Zeka" . Do të ishte mirë më e dobishme pasi që nxënësit nga klasa 9-të po shkojnë në Gjilan dhe kjo po ndikon edhe në zvogëlimin e maturanëve e po ashtu ndikon edhe në zvogëlimin e popullsisë. Mendoj se kjo qështje duhet të trajtohet me një prioritet nga ne.

Egzona Zuzaku-Isufi-deri ku keni arritur me punime tek "Lugu i Verdhë", pasi që kualiteti i këtyre punimeve është tmerrësisht i dobët, unë po mëndoj që është keqpërdorim i taksave tona ku sa për ilustrim i kam printuar edhe fotot ku shihen qartë se çfarë dëmtimi ka në atë pjesë dhe me gjasë i ke ndërruar dy kompani të ndryshme.

Albana Ajvazi-kam një shqetësim lidhur me renovimin e ambullancës në Topanicë, banorët janë ankuar se kanë mbetur mbeturina dhe askush nuk po merret me to a keni marrë ndonjë masë me bërë largimin e tyre?

Labinot Haxhiu-kam kërkuar listën e projekteve që janë të planifikuara për vitin 2024, që keni proklamuar që janë 15 milion nuk kam marrë përgjigje as në seancë e as përgjigje me shkrim që është premtuar nga drejtoria për financa.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj-për strehimoren për qent endacak kjo pronë është afër parcelës që e keni votuar një vendim në seancën e kaluar është në zonën kadastrale në fshatin Hodonovc e evidentuar si pronë është si pronë shoqërore në pronësi të kooperativës bujqësore që menaxhohet nga AKP-ja, të detajuara e keni edhe numrin e parcelës edhe fletën poseduese edhe kopjen e planit të ndarë në material. Sa i përket pyetjes së znj. Egzona rreth procesit mësimor është e vërtet që kemi pasur disa vështirësi për me i mbuluar disa orë në fshatin Busavatë ne jemi takuar disa herë edhe me prind edhe me DKA-në dhe kjo e fundit ka ofruar tri alternativa të cilat kanë qenë të pranueshme mësimdhënës që i ka propozuar DKA-ja, mandej është bërë një zvendësim nga vetë drejtori ashtu siç e parasheh rregullorja. Tani kërkesa është normalizuar se kemi mbajtur një takim ku është dakorduar edhe drejtori edhe prind që kanë qenë në takim. Pjesa tjetër sa i përket " Lugu i Verdhë" kjo është e ndarë në shumë faza tani vetëm pritet të shpallet faza e tretë parku i aventurave, faza e parë ka pasën vështirësi në implementim dhe për shkak të cilësisë së dobët të punimeve është ndërprerë kontrata. Rrugën që e paraqite në foto është rrugë për ciklizëm, rapim dhe ecje dhe nuk është rrugë për vetura këtë e kemi potencuar disa herë. Sa i përket shqetësimeve dhe qështjeve që i ngriti z. Jeton Biqkaj, projekti për asfaltimin e rrugës vetëm se i afrohet pjesës më të madhe edhe të

shtëpisë ku ka qëndruar " Mulla Idriz Gjilani", në do të shfrytëzojmë mundësinë që në një të ardhme të afërt shorim edhe rehabilitimin e plotë të asaj rruge por presim që ministria me i shpall tenderët për këto tri projekte që kanë vendosur me financuar në komunë në aspektin e trashëgimisë kulturore. Sa i përket pyetjes së kapakëve të drunjëve dekorativë edhe në paramasë edhe në shërbimin tonë ka qenë kërkesë që ato të mbeten ashtu siç janë, por në formën e vet të ndryshkut për shkak të estetikës është një formë që aplikohet në shumë shtete të tjera dhe nuk kemi kërkuar që të ketë mbrotjet nga kurizioni apo ndryshku dhe ana tjetër e tortuarit kur të rregullohet do të ketë po të njëjtit kapakë edhe me dimensione edhe në aspektin e ngjyrosjes por do të jenë ngjyrë kafe. Sa i përket sheshit ne e kemi lidhur kontratën e dytë me operatorin ekonomik, ngase kontrata e parë është shkëputur për shkak të neglizhencës, prap kontrata e dytë nuk ka dalë e suksesshme jemi në pritjet të ripërtrajtjes së memorandumit me ministrinë e mjedisit deh pastaj të shpallen prap procedurat për një operator të tretë. Sa i përket pyetjes së znj. Shpresa Shala, për maturan të ky është një shqetësimi përbashkët i yni dhe institucionet bëjnë të pamundurën në si komunë i kemi dhënë shumë rëndësi edhe pjesës së infrastrukturës së brendshme që fëmijët tanë ta kenë si mundësi regjistrimin në shkollë të mesme brenda komunës së vet në ato drejtime që ne i kemi që disa vite disa drejtime të reja. Në vitin e kaluar që ka pasën sukses kemi hapur një përzgjedhje individuale ngase shkollimi i mesëm nuk është obligativ dhe është përzgjedhje e tyre se çfarë duan të vazhdojnë shkollimin. Ne nuk kemi shkollë të mjekësisë dhe kjo nuk mund të arrihet në Kamenicë, kemi dyrt e hapura që organizojnë shkollat ju njoftojnë për programet drejtime, për infrastrukturën për profesorët dhe gjithqka tjetër. Ne kemi ndërmarr disa masa në këtë drejtim ka subvencione për fëmijët edhe për mësime të mesme por ka edhe eliminime të shumë shpenzimeve siç janë edhe shpenzimet e transportit. Njëra nga apkot që është shpërndarë këtë vit është pako matura që përfshinë burimet e shpenzimeve që prinë në Evropë e që është një joshje për fëmijët që përfundojnë klasën e nëntë për tu regjistruar në shkollat e mesme në Kamenicë, ngase asnjë qytet tjetër nuk i praktikon këto politika. Sa i përket shqetësimit të znj. Albana Ajvazit, puna në ambulancë ka përfunduar dhe tani ne kërkojmë nga operatori nëse është bërë pranimi përfundimtar me u larguar mbeturinat nga oborri i ambulancës.

Sejdi Kurteshi-pasi operatori i ka përfunduar punët në shesh e ka ndërprerë kontratën a ka mundësi me urdhnuar atë operatorë dhe me i larguar ato skele dhe mrojtëset që i ka bërë në rrugë .

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj- por mundemi me kërkuar dhe është obligim i operatorit që të gjitha asetet që i ka sjell.

Magbule Kastrati- grupi i PSD-së pasi kryetari nuk i përgjigjet pyetjes së delegatit z. Labinot Hazhiut e lëshojmë sallën.

3. Plani i Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali (2022-2026) në Komunën e Kamenicës,

Nazmije Demolli-Kastrati, Kordinatore e Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijëve - para jush kemi sjell dy plane të veprimit që na obligon legjislacioni në fuqi është Plani i Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali (2022-2026) në Komunën e Kamenicës, i cili ka për qëllim propovimin e ushtrimit të drejtave të komuniteti rom dhe integrimin e tyre në shoqëri. Ky plan është hartuar nga një komision dhe është bazuar në pesë fusha, Arsime, Punësim, Mirëqenie Sociale, Diskriminim, Banim dhe Shëndetësi. Besoj se materialin e keni pasur nëse keni pyetje unë jam këtu për t'iu dhënë përgjigje.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-a keni diskutime për pikën e tretë të rendit të ditës, nëse jo e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e pikës së tretë ?

Për.....18

Kundër0

Absntenim.....0

4. Draft-Plani i Veprimit për Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Komunën e Kamenicës (2024-2026)

Nazmije Demolli-Kastrati-Koordinatorë e Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijëve, - duke qenë se dhuna në familje gjithnjë po njihet si shkelje e të drejtave të njeriut por edhe si kërcënim për demokracinë dhe pengesë për zhvillimin shoqëror, rrezik për paqe të qëndrueshme, pasojat me të cilat po trondisin jo vetëm rrethin shoqëror për gjithë shoqërinë. Andaj si e tillë kërkon një angazhim për gjithë individët dhe mbarë shoqërinë për marrjen e masave të nevojshme në parandalimin e kësaj dukurie mjaft shqetësuese që po mbizotëron. Ky plan do të ndikoj në rritjen e bashkëpunimit mes qytetarëve dhe institucioneve shtetërore dhe ky plan bazohet në tri fusha kryesore: Vetëdijësimi dhe parandalimi, mbrojtja dhe koordinimi dhe fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe riintegrimi, këto janë fusha të cilat i kemi parapa të arsyeshme që të jenë pjesë e këtij plani. Gjithashtu falënderojnë OSBE-në që çdo herë na ka mbështetur deri në këtë pikë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-a keni diskutime për pikën e katërt të rendit të ditës, nëse jo e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e pikës së katërt?

Për.....18

Kundër0

Absntenim.....0

5. Propozim-Vendim për hartimin e Hartes Zonale të Komunës së Kamenicës

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-sa i përket hartave zonale më datë 29 kam pranuar shkresë nga Ministria e Planifikimit Hapësinor ku rreth vendime për hartat zonale kemi nxjerr muajin e kaluar dhe kanë kërkuar që i njëjti vendim të harmonizohet me disa pika. Pika e parë MAPL ka kërkuar që të harmonizohet dhe korrigjohet në aspektin e gjuhësisë. Të nxjerrët vendim për fillimin e procedurave ne nuk e kemi shënuar për fillimin e procedurave, mirëpo e kemi pasën vetëm për hartimin e hartave zonale dhe tani të plotësohet për fillimin e hartave zonale. Neni i 5-të i këtij vendimi ku është zona kadastrale Gogollovc sa i përket nenit 5-të të këtij vendimi lidhur me zonat kadastrale Gogollovc është fat që nuk figuron në ligjin për kufijtë administrativ të komunave, mirëpo e njëjta zonë figuron në gjeoportal dhe në statutin e komunës. Nga komuna jonë kanë kërkuar vetëm këto ndryshime, ndërka pjesa tjetër ishte korrekt.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-a keni diskutime për pikën e pestë të rendit të ditës, nëse jo e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e pikës së pestë?

Për.....19

Kundër0

Absntenim.....0

6. Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Bazë Sh.01 Nr. 1480 i datës:12.05.2022 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- ky propozim ka të bëjë me plotësim-ndryshimin e vendimit bazë 1480, ky propozim ka të bëjë me ndryshimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim ku zyrtari Fatlum Xhaqkaj i cili tani nuk është në marëdhënie pune me komunën tonë, kërkojm që të zavendësohet me zyrtarin Riad Rahimaj. A keni diskutime për këtë pikë, nëse jo vazhdojm me procedurë të votimit.

Kush është për miratimin e pikës së gjasht?

Për.....19

Kundër0

Absntenim.....0

7. Propozim-Vendim për Shpalljen në Interes të Përgjithshëm Publik

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj-e keni fletën poseduese, kopjen e planit, për një parcelë e cila është ende pronësi të AKP-së e cila po nevojitet për ndërtimin e strehimores për qent endacak. Siç e dini strehimoria ka karakter regional dhe fillimisht ne duhet që këtë parcelë ta shapllim interes publik e më pas edhe hartimin e projektit brenda sipërfaqes. Bëhet fjalë për 8163 m², gjindet në zonnë kadastrale në fshatin Hodonovc.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-a keni diskutime për pikën e gjashtë të rendit të ditës, nëse jo e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e pikës së shtatë?

Për.....19

Kundër0

Absntenim.....0

8. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera, nëse jo e shpalli të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet në orën 11:25

Procesmbajtës



Sabile Arifi



Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës

Liridon Kastrati



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTYRIVE CENTAR ZA USLUGU GRADANA	
Sh. U. 01	Nr. Br. 19/189
Nr. i faq. 6	Data: 12/06
Br. str.	Datum: 2024
KAMENICËJA	

ZAPISNIK

Sa V-te sednice Skupštine Opštine

Sednica održana dana: 30.05.2024 u opštinskom objektu i počela u 10:10 časova. Na sednici osim odbornika skupštine, prisutni bili i Predsednik Opštine, direktori nekoliko opštinskih odeljenja, stručna skupštinska Služba, prevodilac, kancelarija informisanja, predstavnik Kancelarije za Evropske Integracije, Koordinatorica Opštinske Jedinice za Ljudska i Dečja Prava, NVO-e, OEBS-a itd. Sednicu otvorio i njome predsedavao Predsedavajući Skupštine Opštine, Liridon Kastrati koji za sednicu predložio ovaj:

Dnevni red

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa IV-e sednice Skupštine Opštine za 2024 godinu,
2. Pitanja zakonodavstva upućena izvršnoj vlasti,
3. Akcioni Plan za Unapređenje Prava Romske i Aškalijske Zajednice (2024-2026) u Opštini Kamenica,
4. Nacrt Akcioni Plan za Koordinacioni Mehanizam Protiv Nasilja u Opštini Kamenica (2024-2026)
5. Razno.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, pre nego počnemo konstatuje se da imamo dovoljan kvorum za početak sednice, imate li predloge za izmene i dopune dnevnog reda? Ako nemate, ja imam dva predloga,

1. Predlog Odluke za izradu Zonalne Mape u Opštini Kamenica

Ko je da se ova tačka stavi u dnevni red?

Za.....svi

Protiv.....0

Uzdržano.....0

Liridon Kastrati- Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – drugi predlog je:

2. Predlog Odluke o izmenama Osnovne Odluke Š 01, Br. 1480 od/datum:12.05.2022 za formiranje komisije za procenu za davanje Opštinske nepokretne imovine na korišćenje

Liridon Kastrati- Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, ova odluka se odnosi na zamenu jednog člana, pošto član koji je bio t.j. Fatlum Xhaqku nije u radnom odnosu u našoj opštini i isti zamenjen sa g. Riad Rahimaj.

Ko je da se ova tačka stavi u dnevni red?

Za.....svi

Protiv.0

Uzdržano.....0

Predsednik Opštine Kamenica, Kadri Rahimaj-na jednoj od prošlih sednica doneli smo odluku za dodelu parcele za izgradnju skloništa za životinje, lugalice i blizu te parcele nalazi se jedna parcela svojina KAI koju treba proglašiti u opšti javni interes kako bi sklonište imalo dovoljan kapacitet na regionalnom nivou. Predlažem da ova odluka se stavi u dnevni red.

3. Predlog Odluke za Proglašenje od Opšteg Javnog Interesa

Liridon Kastrati- Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – ko je da u dnevni red se stavi Predlog Odluka za proglašenje po opštem javnom interesu?

Za.....svi

Protiv.0

Uzdržano.....0

Liridon Kastrati- Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – ko je za usvajanje dnevnog reda?

Za.....svi

Protiv.0

Uzdržano.....0

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa 4 sednice Skupštine Opštine za 2024 godinu,

Liridon Kastrati- Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica –imate li diskusije u prvoj tački dnevnog reda, ako nema stavljam na glasanje.

Ko je za usvajanje prve tačke?

Za.....svi

Protiv.0

Uzdržano.....0

2. Pitanja zakonodavstva upućena izvršnoj vlasti

Magbule Kastrati- za koji deo imovine opštine se radi?

Egzona Zuzaku-Isufi- druga zabrinutost je u selo Busovato u ONSŠ “ Hasan Prishtina “ gde stanovnici potvrđuju da je 9 učenika razreda prošlo preko 6 meseci i su bez nastave da učiteljica Arlinda Demolli odlazila na porodiljsko odsustvo i nije zamenjena sa drugom učiteljicom za 6 meseci takode i treći razred ne održava nastavu skoro 3 nedelje jer i učiteljica Qevsere Haxhiu takođe se nalazi na porodiljsko odsustvo. Vi predsedniče prema nekim informacijama niste upoznati, dok direktor rekao da ne sme jer ga ne slušaju! Vi ste prozivani tokom celog vremena za održavanje nastave i protiv reforme i sada koja reforma ostaje, reforma loše upravljane jel tako? Prema drugoj informaciji kaže

se da uprava osoblja škole posebno direktor je ponavljao nekoliko puta šesti razred, mozete li nam reći koja je prava istina u selo Busovato?

Jeton Biqkaj-imao sam zahtev u vezi infrastrukture kod memorijala " Mulla Idrizi" po mogućnosti da se preuredi jer nema nikakvog efekta jer nema infrastrukturu uzalud se ulaže od ministarstvo innfrastrukture. Drugo je jer prošle godine udarna tema bio trotoar u naselje " Iliria", ograda koja je postavljena kod drveće kao da su postale korozivne što daju loš izgled i ne znam kakav materijal može da je bio, ima li garanciju ili ne? Sledeće pitanje je dokle se stiglo sa radovima na trgu. Prošlo je 5 godina i još uvek nemamo završen trg, stvara jednu smetnju i građanima i preduzećima. U medijima smo videli po pitanju pritiska prema radnicima opštinske administracije kao što je slučaj u odeljenje za kulturu, način i ponašanje kakvo je prema službenicima što nije samo ovaj slučaj administracije.

Shpresa Shala Šermaxhaj-posle komuniciranja koju smo imali sa poludipomiranim većina njih nisu zainteresovani da se upišu u školama u Kamenici, sigurno zbog nedostatka smera sa perspektivom: kao medicina, sestrinski smer ili pak da ima stipendije za učenike koji se upišu u srednjim školama Kamenice. Predsedniče izjavili ste da ćete dodeliti stipendije za studente koji će se upisati na Univerzitetu " Kadri Zeka" . Bilo bi poželjno i korisno jer učenici po završetku 9 razreda odlaze u Gnjilane što utiče u smanjenju maturanata takođe utiče i u smanjenju stanovništva. Mislim ova stvar od naše strane treba se prioritarno od nas tretirati.

Egzona Zuzaku-Isufi-dokle ste stigli sa radovima kod „Žuti Žleb“, pošto kvalitet radova je užasno loš, mislim je zloupotreba naše takse, gde radi ilustracije sam štampala i slike gde se jasno vidi kakva oštećenja ima na tom delu i po svemu sudeći su promenjena dva preduzeća.

Albana Ajvazi-imam zabrinutost u vezi sa renoviranjem ambulante u Toponici, meštani su se žalili jer ima otpad i niko se ne bavi time, da li ste preduzeli neku meru za odlaganje njih?

Labinot Haxhiu-tražio sam spisak projekata koji su planirani za 2024 godinu, da ste reklamirali da su 15 miliona, odgovor nisam dobio ni na sednicu ali ni pismeno a da je od odeljenja za finansije obećano.

Predsednik Opštine Kamenica, Kadri Rahimaj-za sklonište za pse lučalice, ova imovina se nalazi pored parcele koju ste glasali odluku na prošloj sednici. Nalazi se na katastarskoj zoni Odanovce evidentovano kao imovina, to je društvena imovina u svojinstvu poljoprivredne zadruge koju upravlja KAI-a, imate detaljno, imate i broj parcele i posedovni list i kopiju plana raspodeljen uz materijal. Što se pitanja gde Egzone tiče oko nastavnog procesa istina je da smo imali teškoće da bi pokrili nekoliko časova u selo Busovato, mi smo se i sa roditeljima sastali nekoliko puta ali i sa osobljem OOO-e, ovo poslednje je pružalo tri mogućnosti koje su bile prihvatljive. Nastavnika koji predložilo OOO-e, onda je izvršena jedna zamena od direktora onako kako predviđa pravilnik. Sada zahtev je normalizovan, jer smo održali sastanak kojim i direktor i roditelji se složili koji su bili na tom sastanku. Preostali deo što se tiče „Žutog Žleb“ to je podeljeno u mnogo faza, sada se samo očekuje da se proglasi treća faza, park aventura, prva faza bilo teškoće u implementaciji i zbog slabog kvaliteta radova, ugovor je prekinut. Put koji si na slici prikazala je put za bicikliste, trčanje i hod i nije put za vozila. To smo nekoliko puta naveli. Što se uznemirenja tiče i pitanja koje potegao g. Jeton Biqkaj, projekat za asfaltiranje puta samo se približava većem delu i domu gde je boravio " Mulla Idriz Gjilani", mi ćemo koristiti mogućnost da u jednoj skoroj budućnosti vidimo i punu rehabilitaciju te deonice ali čekamo da ministarstvo proglasi tender za ova tri projekta koji su odlučili da finansiraju u opštinu sa aspekta kulturnog nasleđa. Što se poklopaca tiče kod ukrasno drveće i u predmeru i u našoj službi bio zahtev da ostane tako kako su, ali u svom korozivnom obliku zbog estetike je jedan oblik koji se primenjuje u mnogim drugim zemljama, i nismo tražili da ima zaštitu od korozije ili rđe i kada se bude regulisalo drugi deo trotoara biće isti poklopci i dimenzijama i sa aspekta farbanja ali će da budu kafene boje. Što se trga tiče mi smo sklopili drugi ugovor sa ekonomskim operaterem, prvi ugovor je raskinut zbog zanemarnosti, ipak drugi ugovor nije uspeo, čekamo na obnovu memoranduma sa ministarstvom sredine te nakon toga da se ponovo raspisuju postupci za trećim operaterom. Što se pitanje g-đe Shpresa Shala, tiče za maturante to je zajednička zabrinutost, naša i institucija da urade nemoguće. Mi smo kao opština pružali smo značaj i delu unutrašnje infrastrukture kako bi deca imala kao

mogućnost upis u srednju školu u njihovoj opštini u onim smerovima koje imamo neke nove smerove. Prošle godine kada je imalo uspeha u pojedinačnom izboru jer srednje obrazovanje imalo uspeha otvorili pojedinačni izbor pošto srednje obrazovanje nije obavezujuće, i njihov izbor je šta oni žele da nastave od školovanje. Mi nemamo medicinsku srednju školu i to ne može se postići u Kamenicu, imamo otvorena vrata koje škole organizuju, obaveštavaju vas o programima, smerovima o infrastrukturi o profesorima i o svemu ostalom. Mi smo preduzeli neke mere u tom pravcu, ima subvencije za decu i za nastavnike ali ima eliminisanja mnoštvo troškova, kao što su troškovi prevoza. Jedno od paketa koji je ove godine dodeljen je paket koji obuhvata izvori troškova i vodi u Evropi što je jedna privlačnost za decu koja završavaju deveti razred da bi se upisali u srednjim školama u Kamenici, pošto nijedan grad ne praktukuje ove politike. Što se tiče zabrinutosti g-đe Albana Ajvazi, radovi su završeni u ambulanti, i sada mi od operatera tražimo ako je završeno sa konačnim tehničkim prijemom da se otpad otkloni iz dvorišta ambulante.

Sejdi Kurteshi-pošto operater završio radove na trgu, prekinuo ugovor, postoji li mogućnost da se mu se naredi da ukloni te skele i zaštitne ograde koje postavio na put.

Predsednik Opštine Kamenica, Kadri Rahimaj – ali možemo da zatražimo i obaveza je operatera da sve stvari koje doneo skloni.

Magbule Kastrati- grupa PSD/SDP pošto predsednik ne odgovara na pitanje odbornika g. Labinot Haxhiua salu napuštamo.

3. Akcioni Plan za Unapređenje Prava Romke i Aškalijske Zajednice (2022-2026) u Opštini Kamenica,

Nazmije Demolli-Kastrati, Koordinatorica Opštinske Jedinice za Ljudska i Dečja Prava – pred vama smo doneli dva akciona plana koji nas obavezuje zakon na snazi je Akcioni Plan za Unapređenje Prava Romske i Aškalijske Zajednice (2022-2026) u Opštini Kamenica, koji za cilj imaju promovisanje ostvarivanja prava romske zajednice i njihova integracija u društvu. Ovaj plan je izrađen od strane jedne komisije i bazira se na pet oblasti: Obrazovanje, Zapošljavanje, Socijalnu Zaštitu, Diskriminaciju, Stanovanje i Zdravstvo. Uverena sam da ste materijal imali u posed, ako imate pitanja, ja sam ovde da dam odgovor.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica –ima li drugih diskusija po trećoj tački dnevnog reda, ako nema stavljam na glasanje,

Ko je za usvajanje treće tačke?

Za.....18

Protiv..0

Uzdržano.....0

4. Nacrt Akcioni Plan za Koordinacioni Mehanizam Protiv Nasilja u Opštini Kamenica (2024-2026)

Nazmije Demolli-Kastrati-Koordinatorica Opštinske Jedinice za Ljudska i Dečja Prava, -s obzirom da nasilje u porodici stalno je poznato kao kršenje ljudskih prava ali i pretnja za demokratiju i smetnja za društveni razvoj, opasnost za održivi mir, posledice sa kojima potresaju ne samo društveno okruženje nego celo društvo. Stoga kao takav zahteva angažovanje za sve pojedince i celo društvo za preduzimanje potrebnih mera u sprečavanju ove jako mnogo uznemiravajuće pojave koja dominira. Ovaj plan će uticati u povećanju saradnje između građana i državnih institucija i bazira se u tri glavne oblasti: Podizanje svesti i sprečavanje, zaštita i koordinacija i jačanje ekonomije, rehabilitacija i integracija. To su oblasti u kojima imamo razumna očekivanja koja su deo ovog plana. Takođe zahvaljuemo OEBS-a koja je uvek nas pomoglo do ove tačke.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica –imate li diskusije o trećoj tački, ako nema stavljam na glasanje.

Ko je za usvajanje četvrte tačke?

Za.....18

Protiv.0

Uzdržano.....0

5. Predlog Odluke za izradu Zonalne Mape Opštine Kamenica

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica –kada se radi zonalnih mapa, 29-og sam primio pismo od Ministarstvo Prostornog Planiranja a odluku o zonalnim mapama smo prošlog meseca doneli ali oni su tražili da se ista odluka uskladi u nekoliko tačaka. Prva tačka, MALS-a tražilo se da se uskladi i ispravi sa jezičkog aspekta. Da se donese odluka za početak postupaka, mi nismo napisali za početak postupaka, nego samo za izradu zonalnih mapa i sada treba da se dopuni za početak zonalnih mapa. Član 5 ove odluke, odluka gde je katastarska zona Gogolovce, što se člana 5 ove odluke tiče u vezi katastarskih zona Gogolovce sreća je što ne figurira u zakon za administrativne granice opština, ali ista zona stoji u geoportalu i u statut opštine. Od naše opštine su tražili samo ove izmene, dok preostali deo je tačan.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica –ima li diskusije po petoj tački dnevnog reda, ako nema stavljam na glasanje.

Ko je za usvajanje pete tačke?

Za.....19

Protiv.0

Uzdržano.....0

6. Predlog Odluke o izmenama Osnovne Odluke o formiranju komisije za procenu za davanje na korišćenje Opštinske nepokretne imovine, Š 01, Br. 1480 od/datum:12.05.2022

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – ovaj predlog se odnosi na izmene i dopune osnovne odluke 1480, odnosi se izmenama odluke za formiranje komisije za procenu za davanje opštinske nepokretne imovine na korišćenje gde službenik Fatlum Xhaqkaj koji sada nije u radnom odnosu u našoj opštini da se zameni sa službenikom Riad Rahimaj. Ima li diskusije po ovoj tački, ako nema nastavljamo sa postupkom glasanja,

Ko je za usvajanje šeste tačke?

Za.....19

Protiv.0

Uzdržano.....0

7. Predlog odluke za Proglašenje u Opšti Javni Interes

Predsednik Opštine Kamenica, Kadri Rahimaj-imate na uvid posedovni list, kopiju plana za parcelu koja je svojina KAI, potrebna za izgradnju skloništa za pse lutalice. Kao što je poznato sklonište regionalnog karaktera i mi na početku treba ovu parcelu da proglasimo javni interes i posle izradimo projekat u okviru površine. Radi se za 8163 m², nalazi se na katastarskoj zoni u selo Odanovce.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica-ima li za diskusiju po sedmoj tački dnevnog reda, ako nema stavljam na glasanje.

Ko je za usvajanje sedme tačke?

Za.....19

Protiv.0
Uzdržano.....0

8. Razno

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine, ima li drugih diskusija, ako nema više diskusija današnju sednicu proglašavam zatvorenom.

Sednica završena u 11:25 časova

Prevod teksta: Rexhep Ibrahim

Zapisničarka


Sabile Arifi

Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica




Liridon Kastrati

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA OF KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYLLIMIT
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 02 Nr. 18224
U. Br.

Nr. i faq. 2 Data: 24/06
Br. str. Datum: 2024

KAMENICË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.226 dt 04.06.2024

Bazuar në nenet 12 dhe 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenin 11 të për dhëniene në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Qarkorën Ligjore për procedurën e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, neni 23 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nxjerr nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 10.08.2020, nenet 86 dhe 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës në mbështetje të nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Kamenicës Sh.01.Nr.20203 datë 21.06.2023, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2024 sjell këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për miratim të propozim-vendimit për dhëniene e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Qëndresa Gagica Hajdari B.I”, me procedurë të negociimit të ofertës

1. Me këtë vendim “Qëndresa Gagica Hajdari B.I” - (Cetifikata e Regjistrimit: 812163468), me përfaqësuese Qëndresa Gagica Hajdari nga Koretini, Komuna e Kamenicës, i IPET në shfrytëzim afatgjatë prej njëzetë (20) vitesh, pronat e paluajtshme të Komunës, sipas procedurës së negociimit.
 - 1.1. Njësia kadastrale me nr. P-71107079-00002-0, vendi i quajtur, “Vijanski Rid” me sipërfaqe prej 167132 m², në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës.
 - 1.2. Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01372-0, vendi i quajtur, “Vijanski Rid” me sipërfaqe prej 4872 m², në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës.
 - 1.3. Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01371-0, vendi i quajtur, “Vijanski Rid” me sipërfaqe prej 32183 m², në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës.
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale është realizimi i projektit “Ndërtimi i fermës së përzier” ashtu siç është përcaktuar në ofertën e negociuar. Investimi total duhet të arrij 320,000.00 €, me rastin e funksionalizimit të projektit do të angazhoj plus katër (4) punëtorë nuk guxon të bijë më poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim me Komunën e Kamenicës, prej momentit që “Qëndresa Gagica Hajdari B.I”, fillon me kapacitet të plotë.

3. "Qëndresa Gagica Hajdari B.I" në emër të kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale do t'i paguaj Komunës qira vjetore në vlerë prej 1,160.00 € të qarkullimit vjetor nga Subjekti "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", por jo më pak se çmimi i qirasë së tokës i përcaktuar me rregullore Komunale (EUR/vit).
4. Dhënia e pronës së paluajtshme komunale, edhe në këto raste evidentohet, në regjistrin e të drejtave pronësore.
5. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen, me kontratë të veçantë në mes të kryetarit të komunës dhe Kompanisë "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", e cila hartohet dhe nënshkruhet nga palet pas miratimit të Propozimi vendimit të Kryetarit në Kuvend dhe pas aprovimit të ligjshmërisë së vendimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku pjesë përbërse do të jetë edhe Oferta e negociuar, plani i biznesit, plani dinamik dhe projekti ideor, ndërkaq pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës, DPGJK-ja, dhe DUPH-ja.
7. Vendimi shpallet 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisjen Lokale, dhe hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Kamenicës.

Vendimi i`u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;
- Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Arikivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Republika e Kosovës
Republika Kosova
QENDRA PËR SHËRBIM TË QËNDRESA
CENTAR ZA USLUGU GRADANA
Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit
29.05.2024

Sh. 02 Nr. 17733
U. _____ Br. _____
Nr. i faq. 3 Data: 30/05
Br. str. _____ Datum: _____
KAMENICËJA 2024

Në bazë të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajjtshme të Komunës, Kërkesës për Marrjen e Pronës Komunale në Shfrytëzim nga kompania Qëndresa Gagica Hajdari B.I, të datës 24.04.2024 me përfaqësuese Qëndresa Gagica Hajdari, palët negociuese:

1. Kryetari i Komunës së Kamenicës – Kadri Rahimaj, dhe
2. Qëndresa Gagica Hajdari – NUI 812163468

NEGOCIMI I OFERTËS “NDËRTIMI I FERMËS SË PËRZIER” E DATËS 24/04/2024 NGA QËNDRESA GAGICA HAJDARI B.I

Objekti i Negocimit

Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Zona Kadastrale	Nr. i Parcelës	Sipërfaqja
1	Carakoc	P-71107079-01371-0	32183 m ²
2	Carakoc	P-71107079-01372-0	4872 m ²
3	Carakoc	P-71107079-00002-0	167132 m ²
TOTAL:			204187 m²

Pas zhvillimit të negociatave, palët negociuese u pajtuan për pikat si më poshtë:

1. Komuna e Kamenicës jep në shfrytëzim 204187 m² të pronës komunale me kompensim.
2. Pronat komunale objekt i këtij negociimi janë:

Nr.	Zona Kadastrale	Nr. i Parcelës	Sipërfaqja
1	Carakoc	P-71107079-01371-0	32183 m ²
2	Carakoc	P-71107079-01372-0	4872 m ²
3	Carakoc	P-71107079-00002-0	167132 m ²
TOTAL:			204187 m²



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



3. Afati i dhënies me qira të pronës komunale është 20 vite.
4. Qëllimi i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim për subjektin në fjalë është jetësimi i projektit **“NDËRTIMI I FERMËS SË PËRZIER”**, me kapacitetet dhe aktivitetet si në Projektin e propozuar.
5. QËNDRESA GAGICA HAJDARI B.I në emër të kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale do t'i paguaj Komunës qira vjetore në vlerë prej **1,160.00 €**, çmimi i qirasë se tokës është i përcaktuar me rregullore komunale (EUR/vit). Përveç vitit të parë që lirohet nga pagesa e qirasë deri në implementimin e projektit / ndërtimi i fermës.
6. Vlera e investimit nga QËNDRESA GAGICA HAJDARI B.I do të jetë 320,000.00 Euro (Treqind e njëzet mijë euro), sipas planit dinamik zhvillimor e financiar.
7. Për të siguruar investimet dhe realizimin e planit investues QËNDRESA GAGICA HAJDARI B.I detyrohet të ofrojë një policë të sigurimit apo garancion bankar në vlerë prej 20,000.00 euro e cila do të shërbej në rast të dështimit të investitorit
8. QËNDRESA GAGICA HAJDARI B.I raporton te Komuna e Kamenicës çdo 6 muaj mbi implementimin e projektit dhe vlerën e investimeve.
9. QËNDRESA GAGICA HAJDARI B.I duhet të përfundojë investimet sipas planit të biznesit në afat prej një (1) viti nga pajisja me leje adekuate.
10. Numri minimal i punëtorëve, plus 4 punëtorë nuk guxon të bije me poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim me Komunën e Kamenicës, prej momentin që QËNDRESA GAGICA HAJDARI B.I fillon punën me kapacitet të plotë.
11. Do të synohet maksimalisht që punëmarrësit të jenë banorë të Komunës së Kamenicës.
12. Burimet natyrore (si psh burimet e ujit) nuk i takojnë shfrytëzuesit të tokës komunale përveç për përdorim brenda kompleksit të ndërtuar.
13. Banoret përreth që shfrytëzojnë burime të ndryshme natyrore nuk guxojnë të pengohen në shfrytëzimin e atyre resurseve pa miratim paraprak nga Komuna e Kamenicës.
14. Sipas ligjit për sponsorizim të (sportit dhe artit) biznesi do të përzgjedh një nga organizatat kulturore apo sportive të Komunës së Kamenicës për sponsorizim.
15. Ndryshimi i destinimit të shfrytëzimit të pronës komunale nuk mund të bëhet pa miratim paraprak nga Komuna e Kamenicës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



16. Komuna e Kamenices miraton në tërësi projektin dhe veprimtaritë sipas Plan biznesit të projektit gjatë periudhës të paraparë me planin dinamik, ndërsa QËNDRESA GAGICA HAJDARI B.I ruan të drejtën për modifikimin e veprimtarive brenda projektit sipas nevojës, kërkesës dhe rregulloreve në fuqi.
17. Kontrata me kushtet specifike do të përpilohet dhe nënshkruhet nga palët pas aprovimit të Propozimit të Kryetarit në Kuvend, dhe pas aprovimit të ligjshmërisë së vendimit nga ana e institucionit qendror përkatës.

29.05.2024
Kamenicë


Kadri Rahimij
Kryetar i Komunës




Qëndresa Gagica Hajdari – Përfaqësuese,
Qëndresa Gagica Hajdari B.I



Formulari per kerkese apo ankesa

Drejtorati/Njesia

Data 24/04/2024

Drejtoria e Ekonomis, Zhvillimit dhe Diaspores

Mos shkruani në këtë pjesë

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Numri personal

Qëndresa Gagica Hajdari

1232919805

Adresa e vendbanimit

E-mail Adresa

Koretin

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

44577647

Vlera për pagesë: 0.00

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Numri i protokolit

13-300/01-0013095/24

Afati i zgjedhjes

24/05/2024

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

KËRKESË / PLAN BIZNESI PËR DREJTORINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK / KOPJE: KRYETARIT TË KOMUNËS KADRI RAHIMAJ

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshunia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Qëndresa Gagica Hajdari vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonj nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: arsim.keka

PLAN BIZNESI

ZGJERIMI I BIZNESIT- FERMË E PËRZIER

Kamenicë, 2024

IDEJA E PROJEKTIT

Për vite më radh në familjen tonë është diskutuar për cilësinë e veçantë të mishit, çumshtit dhe produkteve të fermës tonë që ka funksionuar në suaza dhe për nevoja të familjes.

Në disa biseda me familje, duke parë edhe mundësitë që tani janë në tregje, kërkesat për produkte të fermave, mbështetjes institucionale nga Komuna dhe qeveria si dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare, fuqisë tonë punëtore si dhe njohjes që e kemi me të gjitha proceset e nevojshme në një fermë të përzier, ne vendosëm që të fillojmë të investojmë dhe të ngrisim një fermë të përzier, fillimisht me lopë qumështore, dhi, dele dhe pula. Kurse në të ardhmën edhe me Bollica.

Investimi planifikohet të bëhet dhe e kemi të vetmen mundësi në parcelat komunale në Çarakoc, në parcelat me sipërfaqe si vijon:

- 01371-0.32183 m²
- 01372-0.4872 m²
- 00002-0.167132 m²

STATUSI I BIZNESIT

Në Republikën e Kosovës i kemi disa modalitete të cilat mund të aplikohen për regjistrim dhe operim të një biznesi, por për arsye që forma më e sigurt dhe më e lehtë edhe për tu zgjeruar dhe menaxhuar në të ardhmen është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar, ne edhe kemi vendosur që ta aplikojmë këtë formë të llojit të biznesit.

Fillimisht do të kemi vetëm një aksionar.

QËLLIMI I BIZNESIT

Qëllimi ynë është që të ndërtojmë një biznes i cili do të jetë i suksesshëm, jetëgjatë dhe i qëndrueshëm pavarësisht sfidave që do të na atakojnë në të ardhmën.

E veçantë e biznesit tonë është që në fillim të realizojmë edhe eksporte, të cilat do të ndikojnë në performancën e biznesit.

Ndërsa, ajo për të cilin ne jemi të përgatitur është që do të na bëjë të dallueshëm për nga natyra e biznesit, sepse klientët do të kenë një game më të gjerë të produkteve në një vend, meqë kemi fermë të përzier me kapacitete më të mëdha, duke filluar nga Lopët qumështore, delet, dhitë, pulat, nga të cilat do të kemi edhe produkte shtesë që janë rezultat i tyre.

Pra qëllim parësor i biznesit tonë dhe shtytësi kryesor i idesë së këtij biznesi është që krahas punësimit të punëtorëve që do të rezultoj me ndikim të uljes së papunësisë, rritje të të hyrave të punonjësve tonë, ndikim pozitiv në zhvillimin socio ekonomik, gjithashtu të kemi edhe një biznes që do të jetë një adresë e njohur për produkte bio- të gjitha në një adresë.

OBJEKTIVAT E BIZNESIT

Nuk mund të zhvillojmë një biznes i cili nuk ka objektiva të qarta, prapë tilla që mund ti masin në kohë, në sasi e në cilësi.

Objektiv afatshkurtër i yni është zjerimi i hapësirës së tokës punuese, rritja e kapaciteteve prodhuese, zgjerimi i dhe ndërtimi i shtallave shtesë, rritja dhe diversifikimi i produkteve për shitje.

Ferma jonë do të ketë këtë përzierje të produkteve për shitje dhe në një sasi vjetore si vijon:

Qumësht Lope; 164,250.00 litra

Qumësht Delje; 60,000.00 litra

Qumësht Dhije; 50,000.00 litra

Vezë fshati, 125,000.00 copë

Mish Viçi, 6,000.00 kg

Mish Kingji, 2,000.00 kg

Mish Edhi, 1,500.00 kg

Mish pule, 10,000.00 kg

Investimi fillestar, do të filloj menjëherë pasi ta nënshkruajm tokën për marrje në shfrytëzim dhe do të vazhdojmë 5 vite në seri investime:

- Objekte, 120,000.00 euro,
- Lopë, 90,000.00 euro,
- Dele, 20,000.00 euro,
- Dhi, 10,000.00 euro,
- Pula fshati, 5,000.00 euro,
- Infrastruktura rrugore, 30,000.00 euro,
- Pastrimi i tokës, rrethojat, 45,000.00 euro

TOTAL : 320,000.00 EURO

Investimet në resurset njerëzore; do të jenë të një fokusi të veçantë, dhe zënë një vend të rëndësishëm në objektivat tona. Së paku do të kemi 4 të punësuar të rregullt, për të cilët do të kujdesemi që të investojmë në trajnimin dhe aftësimin e tyre që të jenë sa më të përgatitur për punë.

VEÇORITË E BIZNESIT

Në Kosovë dhe rajon ka shumëferma e miniferma të tilla, por ferma jonë që në start do ta bëjë diferencën. Përparësia jonë është që ne kemi diversifikim të produkteve, meqë do të operojmë me fermë të përzier.

Gjithashtu cilësia dhe saktësia si dhe shërbimet do të jenë të veçuara, meqë gjithçka që do të ofrojmë, do të bëhet mbi baza të porosive, kurse shpërndarjen do ta bëjme edhe në adresën e klientëve.

KONKURRENCA DHE PËRPARËSITË

Është evidente qëi kemi disa konkurrentë të tregun vendor, të cilët i kemi analizuar me vëmendje, të cilët i kemi kategoriar në prodhues vendor dhe produkte importi.

Por shumica e prodhuesve janë të orientuar në ferma ose miniferma specifike, psh merren vetëm me mish, ose vetëm me qumësht ose vezë, e të tilla, kurse ne do të kemi produkte më shumë dhe shërbime ekstra, meqë do të bëjmë shpërndarje edhe në adresat e klientëve të cilët kërkojnë shërbime të tilla ekstra dhe garanci në cilësi.

KLIENTËT POTENCIAL

Shitjet tona i kemi të orientuara në tregjet e brendshme dhe të jashtme.

Tregu i brendshëm do të dominoj në raport me tregun e jashtëm, pra rreth 80% do të shesim benda Kosove dhe 20% jashtë Kosove.

Në tregun e brendshëm klientët tonë do të jenë pikat shpërndarëse, rrjetet e marketeve, restorantet, kafiteritë dhe organizatat e institucionet e ndryshme vendore e ndërkombëtare. Por një segment i synuar i tregut do të jenë edhe personat fizik dhe ekonomitë familjare.

MARKETINGU

Marketingu është njëri prej segmenteve që sot luan rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në operim të bizneseve. Prandaj edhe neve i kemi kushtuar një rëndësi të veçantë kësaj komponentje dhe kemi vendosur që në kuadër të fermës të kemi një departament të veçantë që do të merret me marketingun dhe nxitjen e shitjeve.

Kryesisht do të jemi të fokusuar te informimi i konsumatorit me cilësinë e produkteve tona, me qëllimin e kompanisë.

Është paraparë që kryesisht të investohet në marketingun e mbështetur nga rrjetet sociale.

PLANI INVESTIV

Plani investiv përfshinë infrastrukturën fillestare për kyqje në rrugë publike dhe në rrjet elektrik, mandej pastrami i tokës, lavrimi i tokës punuese, ndërtimi i shtallave dhe hapësirava përcjellëse dhe në fund blerja e kafshëve dhe shpezëve të parapara në objektivat tona blerëse.

Commented [a1]: Te sqarohet sipërfaqja dhe infot rreth objekteve kryesore dhe përcjellëse.

Shtalla do të ndërtohet sipas standardeve me dimensione 25m gjatësi dhe 12 m gjerësi, me lartësi 4m. Në kuadër të shtallës do të jetë dhoma e ruajtjes së qumshtrir.

Planifikohet të ndërtohet objekti për vendosjen dhe ruajtjen e ushqimit për kafshë, me dimensione (15x12m). Në kuadër të planifikimit të ndertimeve do të jetë edhe objekti ku do të vendosen mekanizmat bujqësorë, me dimensione (20x8m).

FUQIA PUNËTORE

Spektori i burimeve njerëzore - Spektori i burimeve njerëzore ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet ligjore që i përkasin në funksion të zbatimit të kërkesave ligjore të dispozitave të Ligjit për shërbimin civil, Ligjit të punës dhe akteve të brendshme të Komunes; Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiave që ka, bën: - vlerësimin dhe miraton kërkesat për plotësimin e vendeve të punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mundësi Buxhetore të Komunes; - hartimin dhe shpalljen e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira, në përputhje me ligjin dhe procedurat në fuqi; - propozimin e komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për plotësim të vendeve të lira, në përputhje me ligjin dhe procedurat; - hartimin e vendimeve dhe formën e kontratave për kandidatët e përzgjedhur; - iniciimin e procedurës disiplinore ndaj nëpunësve civilë, në rastet e shkeljeve të detyrave të punës dhe shkeljeve të tjera të kodit të mirësjelljes, me kërkesë të zyrtarit kompetent; - zbatimin e pezullimit parandalues, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; - përkujdesje për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në kuadër të Komunes së Kamenicës, në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi; - krijimin, kultivimin dhe ruan relacionet e bashkëpunimit me zyra dhe asociacione që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe obligimet e nëpunësve civilë dhe publikë; - hartimin dhe kujdeset për evidencën e punëtorëve - shërbyesve civilë të drejtorive të administratës komunale, në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislacionit në fuqi; - bashkëpunon me të gjitha drejtoritë komunale; - kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushëveprimtarisë së Spektorit. Njësia e personelit udhëhiqet nga udhëheqësi/menaxheri i Personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunes, në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe procedurat për legjislacionin civil; Udhëheqësi/menaxheri i Personelit dhe zyrtarja e lartë për punën e tij/saj, i raporton Kryetarit të Komunes.

Spektori për integrim evropian - Spektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe qytete, ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë dhe të drejtat dhe detyrimet ligjore dhe kërkesave të Kryetarit të Komunes. Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiave që ka, ky sektor: - ofron mbështetje profesionale dhe teknike për Kryetarin e Komunes, në krijimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve me vende dhe qytete të vendeve të tjera; - kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të vizitave zyrtare jashtë vendit; -

kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të pritjeve zyrtare brenda vendit; - kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të takimeve dhe konferencave rajonale dhe ndërkombëtare, të iniciuara nga Komuna e Kamenicës; - ofron informata dhe dokumente të nevojshme për aktivitetet ndërkombëtare të Kryetarit të Komunës; - ruan, mirëmban dhe sistemon dokumentacionin mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të Komunës së Kamenicës me vende dhe qytete të vendeve të tjera; - kujdeset për shkëmbimin e informacioneve, dhuratave dhe letërkëmbimeve të Kryetarit të Komunës me personalitet ndërkombëtare; - përgatitë materiale të nevojshme për nevojat e Komunës, për çështjet që lidhen me integrimet evropiane; - hulumton programe të ndryshme të asistencës së BE – së, që ofrojnë mbështetje për qeverisje dhe zhvillim lokal; - kryen edhe punë të tjera, me kërkesë të Kryetarit të Komunës dhe në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë-veprimtarisë së Sektorit.

Spektori për komunikim me publikun - ushtron kompetenca në përputhje me kërkesat e Kryetarit të Komunës. Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka: - merr pjesë në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës, brenda dhe jashtë Komunës; - përcjellë mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve, të komiteteve dhe të Kuvendit të Komunës; - koordinon ndërlidhjen me shtypin vendor dhe atë ndërkombëtar, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive dhe zyrtarëve të tjera; - koordinon zhvillimin dhe zbatimin e akteve komunale për komunikim me publikun; - ofron informata për politikatat e zhvillimit të Komunës; - mbikqyrë zbatimin e Strategjisë për komunikim me qytetarë dhe administron Kodin e mirësjelljes së zyrtarëve për komunikim, për të mbajtur standarde të larta etike për zyrtarët për komunikim; - siguron transparencë dhe qasje publike për punën e drejtorëve të administratës komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe medieqe; - informon publikun për vendimet që merr Kuvendi, me anë të konferencave dhe lëshimit të kumtesave për shtyp; - mban lidhje me shtypin lokal dhe mediet elektronike për çështjet që u takojnë organeve të Komunës; - siguron informacione brenda Komunës dhe është në bashkëpunim të përhershëm me drejtorët e drejtorive dhe shërbyesit civilë të punësuar në drejtoritë e administratës; - shoqëron përfaqësuesit e medieqe brenda Komunës dhe regjistron deklaratat e zyrtarëve komunalë dhënë përfaqësuesve të medieqe; - seleksionon dhe arkivon shkrimet e gazetave që kanë të bëjnë me Komunën; - kryen edhe punë të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Kamenicës dhe me rregulloret tjera.

Spektori ligjor i Komunës - në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka: - ofron ndihmë juridike, këshillime dhe bën ekspertizë për nevojat e Kabinetit të Kryetarit, drejtorive, sektorëve/njësiqe dhe të institucioneve të arsimit, të shëndetësisë dhe të ndërmarrjeve komunale; - shqyrton të gjitha projekt rregulloret që propozuesit ia dërgojnë për miratim Këshillit të Drejtorëve, Komiteteve Kompetente dhe Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmëri me ligjet ekzistuese në fuqi dhe Statutin e Komunës; - shqyrton propozimet e vendimeve dhe akteve të tjera që i propozohen Kuvendit për miratim; - harton vendime dhe urdhëresa administrative, të kërkuara nga Kryetari i Komunës; - ruan dokumentacionin e Zyrës ligjore dhe bën shtypjen e të gjitha materialeve dhe akteve të tjera nga përgjegjësiqa e kësaj zyreje; - bashkëpunon me bashkëpunëtorët profesionalë dhe iu ndihmon atyre në aspektin ligjor në përgatitjen e vendimeve dhe akteve tjera juridike, si dhe të materialeve tjera të ndryshme; - përfaqëson dhe mbron interesin e Komunës dhe të institucioneve që financohen nga Komuna në procedurat gjyqësore civile, penale, përmbauese dhe administrative në gjykatat e vendit në të gjitha nivelet; - ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për mbrojtjen e interesit pasuror dhe juridik të Komunës, në përputhje me përgjegjësiqtë e përcaktuara me ligj; - kryen edhe punë të tjera, të parapara me ligj, me Statutin e Komunës së Kamenicës dhe me rregulloret të tjera.

Spektori i prokurimit - aktivitetin, kompetencat dhe përgjegjësiqtë i ushtron në kuadër të Ligjit (në fuqi) për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, akteve dhe autorizimeve të autoritetit kontraktues-Kryetarit të Komunës, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi; Spektori i prokurimit dhe zyrtari i prokurimit, në kuadër të obligimeve, autorizimeve dhe përgjegjësiqeve ligjore dhe duke hyrë në raporte kontraktuale me fondet publike dhe burimet publike, obligohet që ato t'i përdorin në mënyrën më

ekonomike, duke marr parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Sektori i prokurimit, aktivitetin e saj në fushën e prokurimeve e bazon në parimet e ekonomizimit dhe të transparencës, si dhe në atë të barazisë në trajtim të mosdiskriminimit dhe efikasitetit të ushtrimit të aktiviteteve të prokurimeve. Komuna e Kamenicës (si autoritet kontraktues) obligohet, me këtë edhe departamenti/Sektori i prokurimit, që në fushën e menaxhimit, shfrytëzimit, organizimit dhe deponimit në burimet publike dhe fonde publike në fushën kontraktuale të punëve publike në interes për Komunën e Kamenicës, siguron dhe është përgjegjës që: - të gjithë operatorët ekonomik t'i trajtojë në mënyrë të barabartë dhe pa kurrfarë diskriminimi (si dhe pa kurrfarë favorizimi) dhe të veprojë me transparencë të plotë, në të gjitha fazat e prokurimit. Në këtë cilësi zyrtari i prokurimeve obligohet dhe është përgjegjës që të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomik të interesuar në procedurat e tenderimit; - të bëjë publikimin e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit, në përputhje me ligjin; - të sigurojë dhe eliminojë çdo tendencë të dhënies së kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë apo favorizojnë një apo më shumë operator ekonomik; - të sigurojë që të gjitha specifikacionet teknike të precizohen paraprakisht dhe me saktësinë më të madhe të mundshme, duke përfshirë të gjitha kërkesat dhe kriteret, si dhe metodat e përzgjedhjes së dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës; - konkursit të projektimit në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe në dosjen e tenderit, dhe që asnjë kërkesë, kriter apo specifikim që nuk është saktësuar, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes dhe të dhënies së kontratës me fondet publike në Komunën e Kamenices; - të mbajë evidencën për tërë procesin e prokurimeve, prej fillimit të aktivitetit të prokurimit e deri në dhënien e kontratës; - në përputhje me ligjet dhe procedurat në fuqi, palës së interesuar (operatorit ekonomik) t'i ofrojë qasje të drejtpërdrejtë në të gjitha të dhënat lidhur me një aktivitet të prokurimit, përveç informacioneve sekrete afariste; - autoritetit kontraktues, është personi i vetëm i autorizuar për lidhjen dhe nënshkrimin e një kontrate publike në emër të autoritetit kontraktues (Komunës), pas plotësimit të gjitha kushteve të parapara ligjore. - Zyrtari i prokurimit është shërbyes civil dhe përgjigjet sipas dispozitave të Ligjit për shërbimin civil të Kosovës dhe largohet sipas procedurave të parapara me këtë ligj. - Sektori i prokurimit ushtron edhe funksione të tjera administrative në bazë të ligjeve në fuqi dhe akteve tjera nënligjore, si dhe në bazë të vendimeve apo urdhëresave të Kryetarit të Komunës, të cilit i përgjigjen me raporte periodike 3-mujore dhe vjetore. - Kryen edhe punë të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Kamenices dhe me rregulloret në fuqi.

3.TRENDET E FINANCIMIT 2025 DHE VLERËSIMET 2026-2027

ZYRA E KRYETARIT	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
STAFI	28	28	28	28	28
Paga dhe Meditja	227,043.22	249,335.00	250,000.00	255,000.00	255,000.00
Mallra dhe shërbime	168,541.66	195,600.00	200,000.00	200,000.00	200,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere	305,564.90	199,999.00	250,000.00	260,000.00	270,000.00

Shpenzime kapitale	616,710.63	206,075.00	300,000.00	300,000.00	300,000.00
TOTALI	1,317,860.41	851,009.00	1,000,000.00	1,015,000.00	1,025,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	638,385.54	751,010.00			
Te hyrat vetanake	679,474.87	99,999.00			

Tabela e llogaritjeve gjinore nga kategoria për paga

€	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Totali	Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra		%Burra	% Gra
400-600	5	5	31,885.44	39,855.52	71,740.96	44	51
600-1000	10	3	92,911.80	14,566.32	107,478.12	77	23
1000+	4	1	58,545.84	12,235.08	70,780.92	100	
TOTALI	19	9	183,343.08	66,656.92	250,000.00	68	32

Tabela 1.1 Buxhet Administrates në vitin 2016

Buxheti Total	Buxheti Total			Mes. e buxhetit për person:				% e buxhetit për person:	
	Burre	Gra	Totali	Burra	Gra	Shpenzimet për Burra	Shpenzimet për Gra	% Shpenzimet për Burra	% Shpenzimet për Gra
Shqiptarë	18	8	26	183,343.08	66,656.92	9,649.64	7,406.32	73.34	26.66
Serbë	1	1	2				0.00		
Romë									
Të tjerë				250,000.00					

Objektivat për vitin 2025

- Nëse ekzistojnë vende të lira pune, duhet të rritet numri i punonjësve gra, posaçërisht grave të reja, në çdo nivel të vendim marrjes në këtë zyre.
- Subvencionimi I kategorive të caktuara për ndihma momentale

Aktivitetet

- Përdorimi i veprimeve të duhura në rastet kur ka vende të lira të punës të hapura, duke inkurajuar kështu gratë e reja që të aplikojnë

Indikatorët

- Rritja e përqindjes së grave të punësuar në Zyrën e Kryetarit të Komunës, në veçanti të grave të reja së paku për 4% për çdo vend të lirë të punës, kurdo që ekzistojnë vende të lira të punës.
- Subvencionimi I grave dhe burrave për ndihma momentale
- Të subvencionohen kategoritë e caktuara me aftësi të kufizuar/Hendikos, Shoqata e të Verbërve/



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



ZYRA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit:

Deklarata e misionit:

Duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjet në fuqi, Statutin e Komunës, rregulloret, udhëzimet e Kuvendit të Komunës, Zyra e Kuvendit duhet:

- të ofrojë zbatimin e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase;
- të organizojë punën e Kuvendit të Komunës, duke planifikuar buxhetin dhe kujdeset përmenaxhimin optimal të tij;
- kryen punët administrative dhe profesionale, duke përfshirë këtu edhe punët teknike për organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve punuese të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu edhe përpilimin e projekt akteve që i procedohen për miratim këtyre organeve;
- të kryejë punë të tjera për të gjitha organet e administratës, duke përfshirë këtu pranimin e shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare, vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin, punët e arkivit dhe ekspeditivit.

Deklarata e vizionit:

Duke menaxhuar me buxhetin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, konform vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit dhe duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi, duke përfshirë këtu edhe vendimet e Kuvendit të Komunës, angazhohet që qytetarëve të komunës t'u ofrohen shërbime sa më të mira dhe më të shpejta, konform detyrave dhe përgjegjësi të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu lëshimin e dëshmime për anëtarët e Kuvendit të Komunës, përpilimin e vendimeve të Kuvendit, ekspeditivin e akteve zyrtare e materialeve për nevojat e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, bën përpunimin administrativ-teknik të akteve dhe lëndëve, arkivimin e lëndëve etj..

Deklarata e qëllimit:

Qëllimi i punës së kryesuesit të Kuvendit është që, duke e njohur nevojën për të sjellë vendimmarrjen më afër qytetarëve, të promovojë qeverisje të mirë dhe kushte të jetesës për të gjithë qytetarët e komunës, duke avancuar një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale dhe të përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve publike në Komunën e Prishtinës. Me një menaxhim sa më të mirë të punës së Kuvendit, të organizojë sa më mirë punën e personelit të shërbimit profesional të Kuvendit, me menaxhim optimal të buxhetit të saj, të krijojë kushte për punë efikase dhe transparente të Kuvendit të Komunës dhe të trupave të tij, në mënyrë që qytetarëve, në bazë të kompetencave tona, t'u ofrohen shërbime në afatet e parapara me ligj, me pretendim që këto afate të jenë sa më të shkurtra

Kuvendi Komunal	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
stafi	27	27	27	27	27
Paga dhe Meditja	218,574.59	239,958.00	240,000.00	240,000.00	240,000.00
Mallra dhe shërbime	167.30	5,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale					
TOTALI	218,741.89	244,958.00	250,000.00	250,000.00	250,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	218,741.89				
Te hyrat vetanake					

	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Totali	Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra		Burra	Gra
401-600				-	-		-
600-1000	15	13	140,138.00	109,862.00	250,000.00	53.57	46.43
Mbi 1000							
TOTALI	€ 15	13	140,138.00	109,862.00	250,000.00	53.57	46.43

Tabela 1.1 Buxhet Administrates në vitin 2016

Buxheti Total	Stafi			Buxheti Total		Totali	Mes. e buxhetit për person:		% Shpenzimet për Burra	% Shpenzimet për Gra
	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra		Shpenzimet për Burra	Shpenzimet për Gra		
Shqiptarë	14	12		130,508.00	100,424.00	230,932.00	9,322.00	8,368.67	56.51	43.49
Serbë	1	1		9,630.00	9,438.00	19,068.00	9,630.00	9,438.00	50.50	49.50
Romë					950					
Të tjerë	15	13	0	140,138.00	110,812.00	250,000.00	9,342.53	8,524.00	56.06	44.32



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHËSHME
u.d.Drejtorit: Azem Kastrati

Deklarata e misionit:

Drejtoria e Administratës së përgjithshme kryen punë dhe detyra të parapara me legjislacionin në fuqi dhe në bazë të Udhëzimeve Administrative, përmirësimi i strukturës legjislative dhe efikasiteti praktik në implementimin e tyre, lehtësimeve të procedurave administrative, komunikim korrekt me qytetarët qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt qoftë sipas formave të sistemit elektronik, trajtimi me kohë të kërkesave të

qytetarëve, profesionalizmi, paraqesin shtylla bazike përmes së cilave qytetarët absorbojnë shërbime cilësore administrative në Komunë. Një administratë funksionale dhe transparente është gjithashtu një kontribuues i rëndësishëm për legjitimitet të shtetit dhe besueshmërisë. Andaj, për të promovuar performancë më të avancuar të shërbimeve cilësore për qytetarët e Komunës së Kamenicës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, prezanton planin dhe objektivat për vitin 2025.

Deklarata e Vizionit

Vizioni i Drejtorisë së Administratës së përgjithëshme është i bazuar në këto shtylla, të cilat po i paraqesim më poshtë:

- Krijimi i hapësirës për kushte më të mira të punës,
- Thjeshtimi i procedurave për marrjen e dokumenteve
- Trajnimi i resurseve humane për ngritje të profesionalizmit,
- Ri funksionimi i aparatit të pritjes
- Funksionimin e një rampe digjitale tek dera e hyrjes në parking të Komunës,
- Mobilimi i arhivës aktive në Administratën Komunale
- Arkitektura e brendshme, projektimi dhe ndërtimi i Hollit të objektit Komunal

Deklarata e Qëllimit

Qëllimi i Drejtorisë së Administratës së Përgjithëshme është i orientuar me sa vijon:

- Ofrimi shërbimeve sa më cilësore për qytetarët
- Rritja e efikasiteti, efektivitetit dhe azhurnimit në punë
- Rritja e kontrollit dhe raportimit në punë
- Transparencë maksimale
- Rritja e satisfaksionit të qytetarëve në raport me punën e Drejtorisë tonë
- Letësimi dhe ruajtja e dokumentacioneve në Administratën Komunale

Qasja më e lehtë për qytetarët për të kryer shërbime

Drejtorja e Administratës Komunale për vitin 2023 nga objektivat dhe aktivitetet ka arrit të përmbushin nga aspekti i planifikimit dhe pritje në realizim për vitet në vijim. Gjatë vitit 2023 Drejtoria me angazhim maksimal të punëtorëve ka leshuar 40,581 dokumente në sektorin e gjendës civile duke iu bashkangjitur edhe raportin tremujor për vitin 2023 në 1,056 kërkesa të realizuara. Raporti i qendrës për shërbim të qytetarëve për vitin 2023 ka pranuar 40,584 kërkesa, ndërsa për vitin 2024 ka pranuar 18,104 kërkesa. Ka vendosur aparatet e pritjes ku në masë të madhe ka lehtësuar punën e punëtorëve dhe qytetarëve në pritje për të kryer shërbimet sa më cilësore dhe efikase. Është në pritje që për vitin 2023 ka projektin e digjitalizimit të arkivit që ka qenë njëra prej objektivat e kësaj drejtorie të realizohet në vitin 2023.

Objektivat për vitin 2025-2027:

1. Investimi në kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve cilësore-administrative për qytetarët.
2. Ndërtimi i hollit në objektin në Komunë
- 2.1 Qendra për Shërbime me qytetarët me këtë aktivitet do të ofrojë shërbime cilësore për qytetarët dhe do të largojë pengesat burokratike dhe qytetarët ma lehtë do ti qasen shërbimeve.
- 2.2 Ndërtimi(mobilimi) i hollit i objektit të Komunës do të jetë model i ri i renditjes së shërbimeve ku synohet tu kursej qytetarëve kohë dhe energji, si dhe cilësia e shërbimeve dhe akomodimi nuk do t'iu mungojë.
3. Funksionalizimi i zyrës së Kurorave.
4. Mobilimi i sallës së kuvendit Komunal
5. Te ndërtohet parkingu i Komunës
- 5.1 Të behet rregullimi dhe zgjerimi i parkingu dhe te behet me solar.
6. Vendosja e monitorit për njoftime dhe shpallje publike.
- 7 Të ndërtohen shkallët emergjente në objektin e Komunës
8. Shtimi i efikasitetit të punës së ofiqaris dhe Qshqs me theks të veçantë në kohën e pushimeve të bashkatdhetarëve tanë me punë të përkohshme në botën e jashtme.
- 9.Renovimi I kulmit te nderteses Administrates

Drejtoria ADMINISTRATA	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
Stafi	35	35	35	35	35
Paga dhe Meditja	201,152.66	212,354.00	230,000.00	235,000.00	235,000.00
Mallra dhe sherbime	115,932.22	222,750.00	225,000.00	235,000.00	235,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale	64,450.00	170,000.00	50,000.00	35,000.00	50,000.00
TOTALI	381,534.88	605,104.00	505,000.00	505,000.00	520,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-

Grandet Qeveritare	362,742.31	460,104.00			
Te hyrat vetanake	18,792.57	145000			

	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Totali	Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra			
401-600	€ 19	12	118,956.16	80,521.12	199,477.28	59.63	40.37
600-1000	1	2	10,098.00	20,424.72	30,522.72	33.08	66.92
Mbi 1000							
TOTALI	€ 20	14	129,054.16	100,945.84	230,000.00	55.56	38.89

**Tabela 1.1 Buxhet
Administrates në vitin 2024**

Buxheti Total			Buxheti Total			Totali	Mes. e buxhetit për person:		% Shpenzimet për Gra	
Burre	Gra	Totali	Burra	Gra			Shpenzimet për Burra	% Shpenzimet për Burra		
Shqiptarë	19	11	30	123,830.44	77,409.04	201,239.48	6,517.39	7,037.19	61.53	38.47
Serbë	2	4	6	5,223.72	23,536.80	28,760.52	2,611.86	7,190.13	18.16	81.84
Romë										
Të tjerë	21	15	36	129,054.16	100,945.84	230,000.00	6,145.44	6,729.72	56.11	43.89



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB-i) I KOMUNËS SË KAMENICËS 2025-2027

Drejtoria për Financa dhe Buxhet
Drejtores: Ardita Dërmaku

1. MISIONI

Deklarata e misionit : Drejtoria për Financa dhe Buxhet bënë menaxhimin e Buxhetit dhe Financave të Komunës, I siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhim të shpenzimeve dhe informon lidhshpërisht komunal me aktualitetet e ndërlidhura me buxhet të komunës. Ka të punësuar gjithsejt 25 punëtor.

Drejtoria për Financa dhe Buxhet ka katër sektorë:

1. Sektori I Buxhetit

Deklarata e misionit: Sektori I buxhetit bënë përgatitjen e buxhetit Brenda afateve kohore të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe prezentimin e buxhetit në KPF për aprovim dhe mirëmbanë gjitha llogaritë komunale. Për një proces buxhetor më transparent, jep keshilla për KPF mbi buxhetin komunal, menaxhon llogaritë komunale dhe raportet vjetore financiare I raporton në Kuvend, menaxhon thesarin, fondet komunale, mbikqyrë dhe monitoron sistemet dhe procedurat për implementimin e buxhetit etj.

2. Sektori i Tatimit në Pronë

Deklarata e misionit: Menaxhon ekskluzivisht vetëm tatimin në pronë, përgatitjen e faturave, distribuimin e faturave tatimore, inkasimin e tatimit në pronë dhe raportimin e rregullt pranë MF.

3. Sektori I Financave

Deklarata e misionit: Menaxhon Inkasimet e llogarive të arkëtueshme të taksave për ushtrim të veprimtarisë për biznese si dhe menaxhimin qirave të pronave komunale të dhëna me qira.

4. Zyra e Thesarit

Deklarata e misionit: Menaxhon të gjitha shpenzimet e komunës sipas udhëzimeve të dala nga MF, për secilin departament.

2.SITUATA AKTUALE

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për vitin 2023 ka realizuar objektivat e planifikuara –Inkasimet e llogarive të arkëtueshme /tatimit në pronë,taksave për ushtrim të veprimtarisë për biznese ,për qira.Per vitin 2023 kemi arritur te tejkalojmë planifikimin e te hyrave tatimore dhe jo tatimore me aktiveitetet e ndermarrja si ne Sektorin e Tatimit ne Prone po ashtu edhe në Sektorin Taksave Komunale .Kete e kemi realizuar duke përdorur metoda të ndryshme si me shperndarjen e leterkujtesave ,njoftimeve perfundimtare si dhe njoftimieve per pezullim per sherbime komunale.Gjithashtu çdo tatimpagues I cili ka vizituar sektorin e tatimit në prone dhe ka pasur obligime ia kemi mundesuar lidhjen e kontrates me mundesi pagese me keste.Gjatë vitit 2023 kemi lidhur 102 kontrata të cilaty monitorohen rregullisht nga zyrtarët e sektorit dhe telefonohen në rast të vonesave.Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023 kemi realizuar 596,124.93 euro,ndërsa planifikimi ishte 535,046.00 euro,dmth se kemi tejkalim të planit për 11%.

Borxhi I përgjithshëm deri me datën 31.12.2023 është 1,602,915.90 euro,ndërsa më 31.12.2022 borxhi I përgjithshëm ishte 1,676,977.18 euro që nënkupton se kemi zvogëlim të borxhit për 73,961.28 euro.

Gjithashtu si objective ka qenë edhe realizimi I rianketimeve të objekteve ekzistuese për 20 %,mirëpo gjatë 2023 kemi realizuar 1,121 rianketime dmth kemi arritur të realizoojmë 10% të rianketimeve.

Objektivë tjetër ka qenë regjistrimi I objekteve të reja,ku gjatë vitit 2023 kemi realizuar 798 regjistrime të reja.

Rezultate kemi pasur edhe në sektorin e taksave komunale ku gjatë vitit 2023.Planifikimi për taksa komunale mbi shoqërit tregtare për vitin 2023 ishte **60,000.00 €**, ndërsa realizimi deri në fund të vitit arritit në **85,306.25 €**, ose shprehur në përqindje **142.17 %**.

Planifikimi për taksa nga qiraja për objektet afariste, banesore dhe tokave bujqësore për vitin 2023 ka qenë **39,600.00 €**, ndërsa realizimi deri në këtë periudhë kohore është **41,417.29 €** ose shprehur në përqindje **104.58 %**.

Duhet të theksojmë që borxhi i përgjithshëm i subjekteve afariste prej viteve paraprake deri më datën 31.12.2023 është **371,702.32 €** dhe nëse e krahasojmë me vitin 2022 ku borxhi i përgjithshëm ishte **393,077.57 €** kemi rënie të borxhit të përgjithshëm prej **21,375.25 €** apo **5.75 %**.

Sa I përket proceseve tjera,mangësi të shumta që kemi gjetur në pasuritë komunale kemi ndërrmar hapa drejt përmisimit sidomos te E-pasuritë-gjendja fizike dhe gjendja në system si dhe te pasuritë mbi 1,000.00 euro ku duhet të bëhet identifikimi I pronave komunale.Këto përmisime jemi duke I bërë me ndihmën e komisioneve që kemi formuar për secilin proces.

Si dhe jemi në process të hartimit të rregullorë së brendshme për menaxhimin e pasurive jofinanciare.

3.OBJEKTIVAT E DREJTORISË PËR FINANCA DHE BUXHET 2025-2027

- Objektivat

- 1.Realizimi i planit të inkasimit në Sektorin e Tatimit në Pronë dhe Sektorin e Taksava Komunale
- 2.Regjistrimi i objekteve të reja dhe rianketimi 20% I pronave ekzistuese
- 3.Zvogëlim i borxheve aktuale
- 4.Përfshirje sa më e gjerë e Buxhetimit te Përgjegjshem Gjinator në institucion dhe analizë gjinore nëpër gjitha drejtoritë
- 5.Fuqizimi i lidhjes ndërmjet planifikimit dhe buxhetimit
- 6.Hartimi I librit të proceseve për Komunën e Kamenicës
- 7.Përmisimi I menaxhimit të pasurive komunale
8. Fuqizimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes së raportimit dhe shqyrtimit të buxhetit;

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve:

- 1.-Organizimi i fushatave senzibilizuese me qytetar lidhur me obligimet e tyre,njoftimet e tyre me vleren,tatimin mbi tokën,njoftime gjithashtu edhe në faqen e komunës
2. -Mobilizimin e zyrtarëve në teren
 - Vënia në dispozicion të një automjeti për së paku tre ditë në javë gjatë tërë vitit
3. -Shpërndarja e Letërkujtesave për të gjithë obliguesit
 - Shpërndarja e Njoftimeve Përfundimtare për të gjithë tatimpaguesit që nuk i përgjigjen letërkujtesës
 - Hartimi i kontratave për riprogramimin e borxheve për të gjithë tatimpaguesit që kanë borxhe mbi 100 euro dhe kontaktimi i palëve për cdo vonesë në pagesë
 - Shpërndarja e Njoftimeve për pezullimin e shërbimeve komunale për obliguesit që nuk i përgjigjen Njoftimeve Përfundimtare
 - Zhvillimi i kampanjës informuese të tatimpaguesëve për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara përmes përmbaresit
- 4.- Komuna duhet të caktojë një zyrtar për grumbullimin dhe mbledhjen e të dhënave gjinore për cdo aktivitet në kuadër të një Drejtorie
 - Fushatë e re për Buxhetim Gjinator nga praktikant dhe përvojat e fituara nga takimet dhe punëtori
 - Një analizë e buxhetit nga aspekti gjinator në fushën e investimeve kapitale
 - Një analizë e buxhetit nga aspekti gjinator në fushën e kategorisë për mallra dhe shërbime
 - Komuna duhet të ketë një rregullore të brendshme komunale për mbledhjen e të dhënave nga aspekti gjinator
- 5.- Arrihet në kordinim të plotë me drejtoritë komunale
 - Planifikim i mirë i buxhetit para aprovimit në Kuvend
- 6.-Arrihet duke angazhuar një komision perfshire nga një përfaqësues nga të gjitha drejtoritë
- 7.-Me komisionin për vlerësimin e pasurive jofinanciare nën 1,000.00 euro duke paraqitur në mënyrë të detajuar për secilën pasuri edhe vlerësimin dhe pastaj modifikimi në E-pasuri.
 - Me komisionin për identifikimin e pronave komunale në SIMFK

4.Trendet e Financimit 2025 dhe vlerësimet 2026-2027

Buxheti	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
stafi	26	26	26	26	26
Paga dhe Meditja	161,877.65	174,800.00	195,000.00	200,000.00	210,000.00
Mallra dhe sherbime	24,117.70	24,750.00	25,000.00	30,000.00	35,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale			10,000.00		
TOTALI	185,995.35	199,550.00	230,000.00	230,000.00	245,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	185,995.35	194,550.00			
Te hyrat vetanake		5,000.00			

	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Totali	Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra		Burra	Gra
400-600	10	5	65,489.40	31,193.64	96,683.04	67.74	32.26
600-1000	7	4	64,007.64	34,309.32	98,316.96	65.10	34.90
1000+							#DIV/0!
TOTALI	17	9	129,497.04	65,502.96	195,000.00	66.41	33.59

Tabela 1.1 Buxhet Administrates në vitin 2016

Buxheti Total			Buxheti Total			Mes. e buxhetit për person:		Pjasemarrja ne %			
	Burre	Gra	Totali	Burra	Gra		% Shpenzimet për Burra	% Shpenzimet për Gra	% për Burra	% për Gra	Totali
Shqiptarë	17	9	26	129,497.04	65,502.96	195,000.00	7,617.47	\$ 7,278.11	\$ 65.38	34.62	100.00
Serbë											
Romë											
Të tjerë											

5. Propozimet për Politika të reja 2025-2027

Drejtorja per Buxhet dhe Financa – Objektiva e cila është e ndërlidhur me Dokumente Strategjike si dhe politikat e miratuara të Qeverisë **Sigurimi i disiplinës fiskale të qëndrueshme** dhe si aktivitet Buxhetimi Gjiner në institucionet qendrore dhe locale ku Drejtorja per Buxhet dhe Financa ne bashkepunim me Drejtori te tjera komunale ka organizuar takime si aktivitet per permbushjen e ketij objektivi qe ne KAB -2024-2026 te jete I perfshire Buxhetimi I Pergjegjeshem Gjiner. Objektiv tjetër **Përmirësimi i mëtejshëm i efikasitetit operacional, dhe si aktivitet** Fuqizimi i kontrollit të brendshëm Financiar Drejtorja ne bashkepunim me Drejtori te tjera komunale, jane mbajtur takime te vazhdueshme per forcim te kontrollit te brendshem Financiar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, AMBIENTIT DHE INSPEKTORATIT/
ODELJENJE JAVNIH USLUGA, SREDINE I INSPEKTORATA/
DEPARTMENT OF PUBLIC SERVICES, ENVIRONMENT AND INSPECTORATE**

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, AMBIENTIT DHE INSPEKTORATIT

1. Misioni:

Misioni i DSHPAI është ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike duke përfshirë:

- menaxhimin e mbeturinave,
- mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale,
- mirëmbajtje e parqeve shesheve e hapësirave të gjelbra,
- sinjalizimi vertikal dhe horizontal,
- transporti lokal,
- dhënia e vijave urbane, dhe urbano-periferike,
- mirëmbajtja e ndriçimit publik,
- zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik,
- përcjellja dhe pagesa e shërbimeve komunale ,
- furnizim me ujë,
- kanalizimet dhe drenazhimet,
- trajtimi i ujërave të zeza,
- hartimi i planeve dhe rregulloreve komunale,

2. Situata Aktuale:

Përkushtimi aktual i drejtorisë është ofrimi i shërbimeve kualitative dhe rritja e vetëdijes tek qytetarët, si dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike. Të arriturat kanë qenë në një nivel të mirë duke pasur para sysh buxhetin si dhe numrin e stafit profesional për realizimin e projekteve. Do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe financiare që kjo të arrihet. Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake. Ka pasur disa sfida për shkak të mungesës së buxhetit ku disa projekte nuk kanë mundur të realizohen plotësisht, psh. shtruarja e rrugëve me zhavorr, Sinjalizimi vertikal dhe horizontal, pastaj nuk ka pasur mundësi të intervenohet në disa vende ku është e nevojshme rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Përafrimi i përmbushjes së një vizioni të tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime edhe nga donatorët.

3. Objektivat dhe Aktivitetet:

Qëllimi është synimi afatgjatë i cili mundë të arrihet në një moment përtej planit afatmesëm.

Disa politika kanë një shtrirje shumë të gjatë kohore, dhe kjo duhet të reflektohet në periudha të më vonshme.

Mallra dhe Shërbime:

Nr	Bloku kodues	Kategoria	Vlera në €
1	14060	Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra	80,000.00 €
2		Furnizimi dhe vendosja e numrave sipas sistemit të adresave (rreth 6000 objekte)	30,000.00 €
3	14030	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve Lokale	250,000.00 €
4		Mirëmbajtja e ndriçimit Publik	60,000.00 €
5	14030	Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal	40,000.00 €
6	13141	Mëditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	1,500.00 €
7	13460	Shërbime kontraktuese tjera (shërbime të veçanta)	6,700.00 €
8	13470	Pajisje dhe mjete punuese për mirëmbajtjen e ambientit	1,000.00 €
9	13610	Furnizimi për zyre	1,500.00 €
10	13640	Furnizime për aksione të pastrimit	1,000.00 €
11	13650	Furnizimi me veshmbathje	1,500.00 €
12	13950	Regjistrimi i automjeteve	500.00 €
13	13951	Sigurimi i automjeteve	1,100.00 €
14	14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,500.00 €
15		Mjete të pa parashikuara (ujësjellësi , kanalizimi dhe të tjera)	3,000.00 €
16	13810	Avans për para të imëta (p. Cash)	400.00 €
TOTALI			

Shërbimet Komunale

Nr	Bloku kodues	Emërtimi	Shuma në €
1	13210	Shpenzimet e rrymës për Administratën Komunale	36,000.00 €
2	13210	Ndriçimi Publik	115,800.00 €
3	13220	Uji	3,200.00 €
4	13230	Mbeturinat	3,500.00 €
5	13250	Telefonia Fikse	1,500.00 €
TOTALI			160,000.00 €

Objektivat Kryesore :

- Rritja e hapësirave gjelbëruese në komunën e Kamenicës,
- Mirëmbajtja e Hapësirave të hapura publike në baze të planit për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike;
- Mirëmbajtja e rrugëve lokale në komunën e Kamenicës, (rritja e buxhetit);
- Zgjerimi i rrjetit 100% në fushën e mbeturinave;
- Rritja e inkasimit, dhe inkasimi i borxheve nga shfrytëzuesit e HP (kioskat dhe garazhet);
- Mirëmbajtja e infrastrukturës;

- Vendosija e sinjalizimit vertikal dhe horizontal, (rritja e buxhetit për sinjalizim);
- Përmirësimi në furnizimin me ujë;
- Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësve në lokalitete të ndryshme;
- Arritja e marrëveshjes me kompanin “Hidromorava për menaxhimin e rrjetit të kanalizimit në lokalitetet ku nuk menagjohet nga ata;
- Përfundimi dhe funksionalizimi i projektit të ujësjellësit në Roganë, Muqiverc, Dajkoc, Shipashnicë e Poshtme, Novosellë dhe Hodonoc;
- Ndërrimi i gypave të ujësjellësit në lagjen Iliria, dhe Berivojcë;
- Përfundimi i punimeve të bulevardit në qendër, me gjithë infrastrukturën përcjellëse;
- Rregullimi dhe sinjalizimi i parkingjeve në qytet;
- Furnizimi dhe vendosja e numrave në objekte sipas sistemit të adresave;
- Funksionalizimi i NPL “DARDANA” , e cila do të merret me disa fushëveprimtari të ndryshme si:
 - Mirëmbajtjen dhe menaxhimin e hapësirave të gjelbra komunale në qytet,
 - Menaxhimin e lokacioneve për deponimin e materialeve të ngurta,
 - Sinjalizimi vertikal dhe horizontal,
 - Mirëmbajtja dhe menaxhimi i parkingjeve publike në qytet,
 - Menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe familjare,
 - Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal,
- Rritja e numrit të stafit profesional;
- Caktimi i një lokacioni për stacionin e autobusëve;
- Caktimi lokacioneve për deponimin e materialeve të ngurta!

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

- Rritja e hapësirave të gjelbra do të bëhet duke hartuar projekte në fushën e ambientit dhe do të kërkohen donator, në bashkë investim me Komunën;
- Mirëmbajtja e HHP do të bëhet në harmoni të plotë me planin e hartuar nga DEMOS dhe Komuna, për Mirëmbajtjen e HHP dhe Planin Investiv;
- Zgjerimi i rrjetit në fushën e mbeturinave do të bëhet konform planit për Menaxhimin e Mbeturinave, në bashkëpunim me kompaninë Ecohigjiena;
- Rritja e inkasimit do të bëhet duke filluar ngarkesën me taksë për të gjitha kioskat dhe garazhet dhe duke i njoftuar pronarët faktik me masat që do të merren për mos kryerje të obligimeve;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore do të bëhet duke rritur shumën e mjeteve financiare për projektin e mirëmbajtjes së rrugëve lokale, në harmoni me kërkesat e qytetarëve;
- Vendosija e sinjalizimit vertikal dhe horizontal do të bëhet duke rritur vlerën e projektit, dhe duke ju përshtatur nevojave të sinjalizimit në terren;
- Përmirësimi i furnizimit me ujë do të bëhet duke e ndaluar formën e ujitjes, ujitjen e kopshteve, te autolarjet, si dhe duke kërkuar burime të reja të ujit;
- Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit do të bëhet në koordinim me KL, duke marrë pjesë në participim, dhe duke kërkuar donator nga jashtë;
- Nënshkrimi i marrëveshjes me KRU “Hidromorava” për marrjen në menaxhim të ujrave të zeza;
- Pasi jemi në fazën e fundit të zhvillimit të punëve, presim që të përfundoj projekti në tërësi dhe te fillojme me kyçjet individuale të qytetarëve të fshatrave Muqiverc, Dajkoc, Shipashnicë e Poshtme, Rogaqicë, Novosellë dhe Hodonoc.

- Përfundimi i punëve të bulevardit në qendër, me gjithë infrastrukturën përcjellëse do të bëhet në zbatim të plotë të planit dinamik, dhe shfrytëzimi i HP në këtë pjesë;
- Rritja e numrit të stafit profesional do të bëhet sipas organogramit të drejtorisë.

Infrastruktura Publike	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
Stafi	17	21	18	18	18
Paga dhe Meditja	123,595.64	161,000.00	150,000.00	150,000.00	150,000.00
Mallra dhe sherbime	228,596.29	305,650.00	365,650.00	367,660.00	369,750.00
Shpenzime komunale	135,326.09	160,000.00	165,000.00	168,500.00	172,650.00
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale	343,097.58	235,000.00	520,400.00	560,500.00	580,800.00
TOTALI	830,615.60	861,650.00	1,201,050.00	1,246,660.00	1,273,200.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	658,845.70	638,150.00			
Te hyrat vetanake	171,769.90	223,500.00			

	Stafi			Pjesemarrja ne buxhet		Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra
400-600	€ 7	1	50,175.44	10,809.72	60,985.16	82.27	17.73
600-1000	8	2	71,450.08	17,564.76	89,014.84	80.27	19.73
1000+							
TOTALI	€ 15	3	121,625.52	28,374.48	150,000.00	81.08	18.92

Buxheti Total	Stafi				Buxheti Total			Totali		
	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra		Shpenzimet për Burra	Shpenzimet për Gra	% Shpenzimet për Burra	% Shpenzimet për Gra
Shqiptarë	13	2	15	106,581.72	10,809.72	117,391.44	8,198.59	5,404.86	\$ 90.79	9.21
Serbë	2	1	3	15,043.80	17,564.76	32,608.56	7,521.90	17,564.76	46.13	53.87
Romë										
TOTALI	15	3	18	121,625.52	28,374.48	150,000.00			81.08	18.92



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



NJËSIA PROFESIONALE E ZJARREFIKJES DHE SHPETIMIT - KAMENICË KUJTIM KALLABA

MISIONI:

Si reaguesit e parë ndaj zjarrit, sigurisë publike dhe emergjencave mjeksore, fatkeqësive dhe akteve terroriste, Njësia Profesionale e Zjarrfikëjes dhe Shpëtimit në Komunën e Kamenicës me nënstacionin në fsh. Muçivërc mbron jetrat dhe pronat e pasuritë e banorve dhe vizitorve në teritorin e Komunës së Kamenicës.

Njësia Profesionale e Zjarrfikëjes dhe Shpëtimit e avanson sigurinë publike përmes programeve për parandalimin e zjarrit, hetimeve dhe programeve edukative. Ofrimi me kohë i këtyre shërbimeve e mundëson që Njësia Profesionale e Zjarrfikëjes dhe Shpëtimit në Kamenicë me nënstacionin në fsh. Muçivërc të japë një kontribut të rëndësishëm për sigurinë e qytetit, të zonës së përgjegjësis dhe përpjekjeve të sigurisë kombëtare.

Situata Aktuale:

Njësia Profesionale e Zjarrfikëjes dhe Shpëtimit mbulon teritorin e Komunës së Kamenicës dhe Ranillugut e cila shtrihet në pjesën lindore të Kosovës e cila kufizohet me Komunën e Gjilanit, Artanës (Novobërdës), Prishtinës dhe me teritorin e Serbis me Komunën e Medvegjës, Vranjës dhe Bujanovcit.

Komuna e Kamenicës dhe Ranillugut ka një sipërfaqe prej 523 km² me 76 vendbanime prej 46,800 banor me një densi prej 111 banorve në një km² në pikën më të ulët mbidetare 380 m (dheu i bardh) dhe ate më të lartë 1,223 m(guri i zi).

Zona e përgjegjshis ka objekte me rendësi administrative, industriale, kulturore, religjioze etj, në të cilën 35 vendbanime janë të banuar vetëm me shqiptar, 27 vetëm me sërbe dhe 14 të përziera.

NJPZSH ka të punësuar 32 Zjarrfikës, 24 punojnë në Stacionin e zjarrfikëjes në Kamenicë dhe 8 punojnë në nënstacionin në Muçivërc, në një ndrim janë 7 zjarrfikës (5 në Kamenicë dhe 2 në Muçivërc).

Mosha mesatare në stacionin e Njesisë Profesionale të Zjarrfikëjes dhe Shpëtimit është llogaritur nga 32 puntorë të të gjitha stukturave organizative, mosha mesatare është 42.34 vjet, prej tyre 4 zjarrfikës jan prej moshës 20 – 30 vjeq, 10 zjarrfikës jan prej moshës 31 – 40 vjeq, 11 zjarrfikës jan prej moshës 41 – 50 vjeq dhe mbi 50 vjeq janë 7 zjarrfikës.

me strukturën gjinore M – 32, dhe strukturë nacionale:31 shqipëtar dhe 1 serb.

Njësiti Profesionale të Zjarrfikëjes dhe Shpëtimit – janë njësi profesionale operative që marin pjesë në intervenimet për zjarrfikje dhe shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë në situata emergjente, si dhe zbatimin e masava parandaluese të mbrojtjes nga zjarri dhe kryerjen e veprimtarive tjera të përcaktuara me ligj.

Natyra e punës në Njësia Profesionale e zjarrfikëjes dhe shpëtimit në përgjithësi ka specifika të veçanta që dallon shumë nga puna e shërbimeve, institucioneve, agjencive dhe organizatave të tjera.

Puna e zjarrfikësve bazohet në: Profesionalizëm, Përgjegjësi të përhershme, Gatishmëri konstante, Siguri, Humanizëm, Shpejtësi, Kreativitet, Objektivitet dhe diciplinë vullnetare etj.

Punën e përditëshme të zjarrfikësit e karakterizon: Veprimi nën ndikim të rrezikut permanent për jetë gjatë aksioneve të fikjes së zjarrit dhe shpëtimit të njerëzve e të pronës si: puna në lartsi, podrume e thellsi nëntoksore, në ujë gjatë vërshimeve të mëdha, kërkim-shpëtimin e përsoneve të rrezikuar në/nën ujë, në ndikimin e temperaturave të larta, temperaturave shumë të ulëta, puna në zona me rrezik nga rrënimet strukturale, në zona të kontaminuara me materje të rrezikëshme helmuese, korrozive, biologjike dhe radioaktive.

Zjarrfikësi kujdestaron pandërprerë me nivel të lartë gatishmërije me punë në ndrrime, gjatë festave kombëtare e shtetërore madje edhe në pushimet dimërore dhe verore.

Objektivat :

- MPB / AME në bashkpunim me Komunën duhet të ndërtoj Stacion të ri me 6 garazha me infrastruktur moderne për ti zhvillu aktivitetet profesionale dhe rritjen e gatishmëris.
- Të rritet numri i zjarrfikësve për 8 zjarrfikës ku 4 zjarrfikës do të punsohen në Stacionin Qendra në Kamenicë dhe 4 zjarrfikës në nënstacionin në Muçivërc.
- Të bëhet furnizimi me një kamion Auto shkalle si dhe një automjet komandues e modelit xhip me drita rotacioni dhe alarm.

Emri i Drejtorisë/Programit

NJËSIA PROFESIONALE E ZJARRFIKËJES DHE SHPËTIMIT

Departamenti: Zjarrfikësat dhe Inspektimet, Kodi i prog. 18433, Kodi funk. 0320

Objektivat Kryesore :

Për ta realizuar punën e përditëshme në dy Stacione, kryerjen e punëve profesionale dhe rritjen e nivelit të gatishmëris emerxhente në Njësia Profesionale të Zjarrfikëjes dhe Shpëtimit kemi parapar këto objektiva:

- Pranimi dhe dorzimi i detyrës në gjendje të rregullt dhe gatishmërie,
- Brifingu për rastet e intervenimeve dhe caktimi i detyrave,
- Menagjimi i kohës
- Shkruarja e rregullt e raporteve ditore dhe plotsimi i formullarve për intervenim
- Identifikimi i problemit
- Parashikimi i Strategjisë dhe detyrave
- Trajnimi i përditshëm i zjarrfikësve në Stacion sipas planit javor/vjetor
- Ushtrimet psiko-fizike
- Analiza e Intervenimeve - zjarreve dhe Debrifingu
- Zhvillimi i metodës së Hulumtimit
- Plani i veprimit
- Motivimi i stafit

-Objektivat e mësipërme të NJPZSH do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

- Motivi për punë
- Staf i mire i trajnuar
- Gatishmëria për tu përgjigjur për mobilizim dhe pranuar punë shtesë
- Puna grupore dhe rutina në punë
- Mirmbajtja e stacionit dhe riparimi i automjeteve
- Vullneti për demonstrim publik me strukturat emergjente

.Trendet e Financimit 2025 dhe vlerësimet 2026-2027

Zjarrefiksati	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
Stafi	33	33	33	33	33
Paga dhe Meditja	288,584.61	295,000.00	300,000.00	300,000.00	300,000.00
Mallra dhe shërbime	22,988.10	55,000.00	55,000.00	60,000.00	65,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale			80,000.00		
TOTALI	311,572.71	350,000.00	435,000.00	360,000.00	365,000.00

Burimet e Financimit				-	-	-
Grandet Qeveritare	311,572.71	350,000.00				
Te hyrat vetanake						

	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Pjesemarrja ne buxhet	
	Burra	Gra	Burra	Gra		
			Stafi		Totali	
			Burra	Gra	Burra	Gra
400-600	29		258,848.31		258,848.31	100.00
600-1000	4		41,151.69		41,151.69	100.00
1000+					-	
TOTALI	33		€ 300,000		300,000.00	100.00

Buxheti Total	Stafi		Buxheti Total	Totali	Mes. e buxhetit për person:				
	Burra	Gra			Burra	Gra	Shpenzimet për Burra	Shpenzimet për Gra	% Shpenzimet për Burra
Shqiptarë	32		292,311.00	292,311.00	9,134.72		100.00		
Serbë	1		7,689.00	7,689.00	7,689.00		100.00		
Romë									
TOTALI	33		300,000.00	300,000.00	9,090.91		100.00		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyrës Komunale për Komunitete dhe kthim për vitin 2025-2027

Deklarata e Misionit:- Zyra Komunale e Komuniteteve konform gjitha akteve në fuqi e ka mandatin e vetë, që të kujdeset për interesat e komuniteteve joshumicë, në komunat të cilat përbëjnë numër të rëndësishëm të tyre. Në të vërtetë merret me çështje të rëndësishme të kthimit, të zhvendosurëve dhe interesave të tyre të cilat janë të garantuara përmes ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe gjitha ligjeve pozitive të cilat i ka aprovuar Kuvendi i Kosovës. Mandej për së afërmi bashkëpunon me komunitetet dhe integrimin e tyre në strukturat komunale. Përmes shërbimeve të saja, procedon kërkesat e komunitetit, drejtorisë komunale, drejtorive të saja e në pajtim me llojin e kërkesave. Misioni i zyrës është që thelbësisht të përmirësojë pozicionin e komunitetit joshqiptarë, përmes një qasjeje aktivisht të shprehur dhe të ngrisë nivelin e integritit në një bazë barabasësie dhe pa kurrfarë diskriminimi.

Deklaratë e Vizionit: - Për realizimin e sukseshëm të misionit, Zyra komunale për komunitete dhe kthim, konform me mandatin e saj, me të cilin garantohet përmes disa akteve dhe nënakteve ligjore, aktivisht dhe për së afërmi bashkëpunon me organet komunale, Kryetarin e komunës. Luan rol të rëndësishëm në të gjitha proceset e komunës. Prezentimi i rregullt në gjitha grupet punuese komunale për kthim, mbledhjet e sigurisë, këshillit lokal për parandalimin e kriminalitetit, mbledhjeve regjionale me zyrat tjera regjionale të komuniteteve, një sërë takimesh në nivelin regjional, pjesëmarrje në komisione të ndryshme, grupe punuese etj. Bashkëpunimi me të gjitha strukturat komunale, puna me gjitha komunitetet dhe ofrimin e tyre dhe integrimin, krejt me qëllim të krijimit të një klime të përshtatshme dhe mundësitë e një jete të përbashkët. Në këtë mënyrë mundësohet qëndrueshmëria afatgjatë dhe zhvillimi i komuniteteve e me këtë dhe jeta e tyre më e mirë dhe më e sigurtë si në Kamenicë ashtu edhe në tërë Kosovën.

Deklarata e Qëllimit:-

- Të shtohet informimi i personave të zhvendosur, të kthyerëve dhe të riatdhsuarëve për të drejtat e tyre dhe rritja e kapaciteteve të tyre si dhe arsimimi joformal në harmoni me ligjin mbi barazinë gjinore.
- Promovimi i dialogut ndëretnik përmes kulturës, dhe sportit si dhe inicimi i bashkëpunimit ndëretnik në mesin e të rinjëve dhe grave si dhe ofrimi i përkrahjes për takime të tilla.
- Rritja e përfshirjes sociale për të kthyerit dhe personat e atdhesuar përmes bashkëpunimit me Qendrën për punë sociale dhe me OJQ-të.
- Promovimi i potencialit ekonomik të Kamenicës te komunitetet dhe donatorët..

Objektivi:

1. Të shtohet informimi te personat e zhvendosur, të të kthyerit dhe personat e riatdhesuar për të drejtat e tyre, shtimi i kapaciteteve të tyre në arsimimin joformal në harmoni me ligjin mbi barazinë gjinore

Aktivitetet :

1. Përgatitja, shtypja dhe distribuimi i „flajerve“ informativ me shënime për të drejtat në kthim, riatdhesim dhe ligjin mbi barazinë gjinore në masë prej mbi 200 copë/njësi.
2. Organizimi i vizitës Shko dhe Shif për personat e zhvendosur në vendet e zhvendosura në Serbi në lokalitetet Nish, Jagodinë dhe Beograd
3. Organizimi i tryezës për anëtarët relevant të „OKR-së“ me temën forcimi i kapaciteteve të arsimimit joformal të kthyerëve, të riatdhesuarëve në harmoni me ligjin mbi barazinë gjinore
4. Organizimi i tryezës me temën „Kthim në Kamenicë prej OJQ-së lokale 2 prej komunitetit serb dhe me përfaqësues të 10 fshatrave në Komunën e Kamenicës me banorë serb me temën „Integrimi i kthimit“
5.
5. Inicimi dhe promovimi i vlevshmërisë të konferencës së donatorëve me temën “Më shumë punësim për kthim të sigurt” për Rajonin e Anamoravës

2. Promovimi i dialogut ndëretnik përmes kulturës dhe sportit dhe inicimi i bashkëpunimit ndëretnik në mes të rinjëve dhe grave si dhe ofrimi i përkrahjes tubimeve të tilla

Aktivitetet :

1. Organizimi i tryezës me temën “Dialogu ndëretnik-Interkulturalizmi” me 40 të rinj të komuniteteve, shqipëtare, serbe dhe rome nga Komuna e Kamenicë, Ranillugut, Novobrdës dhe Gjilanit
2. Organizimi i aktiviteteve ndëretnike sportive me 50 të rinj nga shkollat fillore dhe të mesme të Novobërdos, Parteshit, Ranillugut dhe Gjilanit
3. Organizimi i pjesëmarrjes të komunitetit Rom nga Berivojci për Ditën e Romëve.
4. Organizimi i aktiviteteve për nderë të shënimit të “Ditës të Refugjatëve” me nga 20 të rinj të komunitetit shqiptar dhe serb

3. Rritja e përfshirjes sociale të të kthyerve dhe personave të riatdhesuar përmes bashkëpunimit me Qendrën sociale për punë dhe OJQ-ët lokale

Aktivitetet :

1. Organizimi i takimeve të 10 të kthyerëve dhe 10 të riatdhesuarëve me Komitetin për Komunitete në Komunën e Kamenicës, me Drejtorinë për Punë Sociale dhe me OJQ-të lokale.
01 Organizimi i sesioneve me personat e riatdhesuar dhe të kthyerit me temën: “Idetë tona për projekte”. Përmes aftësisimit për referimin e iniciativave qytetare dhe pjesëmarrja në debatet publike për buxhetin

4. Promovimi i potencialit ekonomik Kamenicë te komunitetet dhe donatorët

Aktivitetet :

1. Përkrahje mbajtjes “Java e aktivitetit të grave” në Kamenicë përmes prezantimit të trashëgimisë historike dhe kulturore në Kamenicë
2. Shënimi ditës për Zbutjen e varfërisë përmes prezentimit të kuzhinës shtëpiake në Kamenicë
3. Inicimi dhe promovimi i rëndësisë të konferencës së donatorëve me temën “Potencial Kamenica”

TRENDET E FINANCIMIT 2025 DHE VLERËSIMET 2026-2027

Drejtoria ADMINISTRATA	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
Stafi	8	8	7	7	7
Paga dhe Meditja	49,333.08	47,800.00	47,000.00	50,000.00	55,000.00
Mallra dhe sherbime	4,924.99	4,950.00	5,000.00	7,000.00	10,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere	4,942.00	5,000.00	5,000.00	7,000.00	10,000.00
Shpenzime kapitale					
TOTALI	59,200.07	57,750.00	57,000.00	64,000.00	75,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	54,258.07	57,750.00			
Te hyrat vetanake	4,942.00				

Analiza gjinore e LLogaritjes e Pagave për vitin 2025

	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Totali	Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra		Burra	Gra
400-600	3	2	17,444.60	12,080.04	29,524.64	59.08	40.92

600-800		2		17,475.36		17,475.36	100.00	
800+							-	
TOTALI		5	2	34,919.96	12,080.04	47,000.00	74.30	25.70

Buxheti Total	Stafi			Buxheti Total			Pjesemarrja ne buxhet		Totali	
	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra	Totali	Shpenzimet për Burra	Shpenzimet për Gra	% Shpenzimet për Burra	% Shpenzimet për Gra
Shqiptarë										
Serbë	3	3	6	27,637.64	12,080.04	39,717.68	9,212.55	4,026.68	69.59	30.41
Romë	1		1	7,282.32		7,282.32	7,282.32		100.00	
TOTALI	4	3	7	34,919.96	12,080.04	47,000.00	8,729.99	4,026.68	74.30	25.70



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Informatë rreth kultivimit të kulturave bujqësore dhe prioritetet e tyre

Misioni:

Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka për mision zhvillimin e Bujqësisë me sektorët e sajë si : sektori i Blegtorisë, Pemëtarisë, Lavërtarisë, Perimëtarisë, dhe përpunimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura, ruajtjen dhe përpunimin e lëndës drusore, vjeljen ,ruajtjen dhe përpunimin e frutave malore, bimëve mjekuese etj. Ka për mision zhvillimin e turizmit rural, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së ushqimit me standardet e BE (ISO dhe HASAP) , rajonizimin e kulturave bujqësore, ruajtjen dhe rregullimin e tokave bujqësore dhe pyjore.

Gjendja aktuale:

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Kamenicës është 417 km² prej tyre 58 % janë tokë bujqësore, kurse 42 % janë tokë pyjore. Bujqësia në komunën tonë është sektori më i rëndësishëm pasi që pjesa më e madhe e popullatës së komunës sonë është e angazhuar në këtë sektorë. Gjendja e bujqësisë në komunën tonë karakterizohet me ferma të vogla dhe mesatare 2.2 - 2.4 ha., të shpërndarë në 7 - 8 ngastra për fermë. Me prodhimtari nën mesatare të rajonit, pa mbështetje profesionale. Mbi 70 % e popullatës jeton në zonat rurale,dhe ekskluzivisht merren me bujqësi dhe pylltari.

Drejtoria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural është e fokusuar ne e mbajtjen e shënimeve, statistikave te veprimtarive si ne punimin e tokave bujqësore ku deri me tash ne bazë të statistikave rreth 4000 hektarë janë tokë e punueshme me drithëra grurë dhe misër, ku planifikohet qe të rritet sipërfaqja me ujitje. Ujitja sistem i lirë do te ndikoj në diversifikimin e kulturave bujqësore, ku në një pjesë të këtyre tokave mund te kultivohen dy prodhime bujqësore brenda një viti kalendarik. Po ashtu objektivi tjetër ne këto vite 2023-2027 planifikohet qe te behet përmirësimi i racës se gjedhit me ane te inseminimit artificial ku ky projekt planifikohet te zgjasë 2 vite, po ashtu ne ketë sektor objektivi i drejtorisë është edhe subvencionimi i fermerëve prodhues te qumështit për 5 cent për litër me mundësi rritje për sasi. Objektivi tjetër i DBPZHR do te jetë edhe ruajtja e shëndetit publik përmes projektit 2 vjeçar i trajtimit te qenëve endacak ku planifikohet te behet menagjimi me ta. Po ashtu objektivi i DBPZHR prapë do te jete sipërfaqja me mbjellje pranverore dhe vjeshtore në subvencionimin e fermerëve me furë te grurit dhe misrit si dhe plehrave minerale

Objektivat :

- DBPZHR, në bashkëpunim me MBPZHR dhe shoqatave të huaja, i ndihmohet fermerëve në mbështetje materiale dhe profesional.
- Daljet në teren, vizita fermerëve dhe mbajtja e trajnimeve brenda vitit 2024
- Planifikimi dhe Realizimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore,
- Mbajtja e temave trajnuese për fazën pranverore,
- Dhënia e këshillave fermerëve për aplikim për subvencione në MBPZHR.,
- Takim me fermerët të organizuar nga DBPZHR rreth subvencionimit të fermerëve nga komuna.;
- Fazën e aplikimit për Pagesa direkte – Subvencione nga MBPZHR. – AZHB. - ja,
- Faza e aplikimit të fermerëve për Grante në kuadër të MBPZHR.,
- Përgatitjen e fermerëve për aplikim në Grante të MBPZHR.,
- Pastaj mbajtja e temave këshilluese për sektor të ndryshëm nga zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë,
- Në organizimin e mbajtjes së temave trajnues – këshilluese në kuadër të MBPZHR.,
- Përpilimi i raporteve të punës për departamentin e shërbimeve këshilluese në MBPZHR,
- Bashkëpunimi me organizatën e huaja ,(ndërkombëtare),
- Vlerësimet e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjerë sipas kërkesave të fermerëve,
- Organizimin dhe përfundimin e fushatës së Korrje-shirjeve në Komunë,
- Inicimi i projekteve nga buxheti i Komunës dhe Drejtorisë, si subvencionimi i disa sektorëve të bujqësisë psh: në Blegtori, Bletari, Lavërtari, Perimekulturë, Pentari etj.
- Fillimin, përcjelljen dhe përfundimin e projekteve nga DBPZHR,
- Kryerjen e projekteve me organizatat e huaja
- Pastaj kryerja e akteve administrative,
- Regjistrimi i fermerëve të rinjë në programin e eFR-ës të MBPZHR.
- Përgatitja e raportit të punës për gjashtë mujorin e parë dhe të dytë,
- Përgatitja e raportit të punës një vjeçar

Objektivi i DBPZHR është edhe përkrahja e fermerëve bletarë në mbjelljen e kulturave mjaltëdhënës ne sipërfaqe ku është e fokusuar bletaria ne Kamenicë. Pemëtaria ne viset rurale do te përkrahet edhe sektori i hortikulturës ku do te përfshihen mbjellja e fidanëve te pemëve te ndryshme si dhe ne disa sipërfaqe komunale do te mbillen edhe drunjë dekorativ mjaltëdhënës. Sektori i perimekulturës do te përkrahet me serra te vogla 1 deri ne 3 ari për fermerë te vegjël.

❖ **Aktivitetet realizohen duke u bazuar në objektivat dhe planifikimin brenda vitit 2023-2024**

Nr	Emertimi I projektit	Shuma për vitin 2023
1.	Subvencionimi I fares së grurit dhe plehut artificial	13,138.25€
2.	Subvencionimi I fermerëve me mekanizëm bujqësor	22,490.00 €
3.	Subvencionimi I qumështit 6 Mujori i pare-2023	41,999.85 €
4.	Inventarizimi i tokave bujqësore	299,225.00 €

❖ **Aktivitetet të realizuara duke u bazuar në objektivat dhe planifikimin brenda vitit / 2024.**



Nr	Emertimi I projektit	Të realizuara dhe në realizim	Shuma për vitin 2024
1.	Subvencionimi i qumështit 6 Mujori I Dytë-2023	I realizuar	34,568.55€
2.	Menaxhimi dhe trajtimi I qenëve endacak	Në realizim	20,000.00€
3.	Subvencionimi I fermerëve me sere dhe motokultivator (Komuna- Islamic relief Kosovo)	Në realizim	128,804.35 €
4	Insiminimi artificial I lopëve qumështore	Në realizim	20,000.00 €
5.	Subvencionimi I fares sëgrurit dhe plehut artificial	Në realizim	15,000.00 €
6.	Subvencionimi I qumështit 6 Mujori i pare-2024	Në realizim	40,000.00 €
7.	Subvencionimi I fermerëve me mekanizëm bujqësor	Në realizim	10,000.00 €

❖ **Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :**

Aktivitetet- Klasifikimi i tokave bujqësore

- Marrja e mostrave të dheut, anjaliza, përbërsit dhe vetit
- Krijimi i hartave digjitale të tokave vetit e tokave bujqësore ?
- Orijetimi i fermerve në përzgjedhjen e mbjelljes së kulturave bujqësore

Aktivitetet -Rritja e sasisë së prodhimit

- Ngritja e 30 serave dhe 70 motokultivatorëve në vitin 2024
- Furnizimi i tregut me prodhimev të freskëta vendore dhe zvoglimi i importit
- Subvencionimi i pemëtarisë nga MBPZHR
- Trajnimi fermerve dhe vizita e serave jashtë Komunës

Aktivitetet -Insiminimi artificial i lopëve qumështore

- Përmirsimi racor

- Rritja e fondit blegtoral nga 3,000 në 4,500 krer në 5 vitet e ardhëshme
- Subvencionimi i lopëve qumshtore nga MBPZHR
- Aktivitetet- Subvencionimi i qumshtit për rritje të cilsisë MBPZHR
- Subvencionimi i qumshtit për litër-sasi
- Trajnimi i fermerve blegtorë

Aktivitet - Menaxhimi i qenve endacak

- Evidentimi, matrikulimi qenve endacak
 - Kastrimi
 - Dehelmetizimi
- Mbrojtja e shëndetit publik

❖ **Aktivitetet realizohen duke u bazuar në objektivat dhe planifikimin brenda vitit / 2025.**

Nr	Emertimi i projektit	Shuma për vitin 2025
1.	Subvencionimi I fares së grurit dhe plehut artificial	15,000.00 €.
2.	Subvencionimi I fermerëve me mekanizëm bujqësor	30,000.00 €
3.	Subvencionimi I qumështit për litër	70,000.00 €
4.	Insiminimi artificial	20,000.00 €
5.	Trajtimi I qenëve endacak	20,000.00 € /nga mallrat dhe shërbimet
6.	Pyllzimi me drunjë në pronat Komunale	10,000.00 € /nga mallrat dhe shërbimet
7.	Subvencionimi i fermerëve bletarë me farë nga bimët mjaltëdhëse dhe dysHEME antivaroa	5,000.00 €.

❖ **Aktivitetet realizohen duke u bazuar në objektivat dhe planifikimin brenda vitit / 2026.**

Nr	Emertimi I projektit	Shuma për vitin 2026
1.	Subvencionimi i fares së grurit dhe plehut artificial	15,000.00€
2.	Subvencionimi i fares së misrit dhe plehut artificial	15,000.00€
3.	Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor	35,000.00 €
4.	Subvencionimi i qumështit për litër	70.000.00 €

5.	Insiminimi artificial i lopve qumështore	20.000.00 €
6.	Përkrahja e fermerëve bletarë	5,000.00 €
7.	Trajtimi i qenëve endacak	20,000.00 € /nga mallrat dhe shërbimet

❖ Aktivitetet realizohen duke u bazuar në objektivat dhe planifikimin brenda vitit / 2027.

Nr	Emertimi I projektit	Shuma për vitin 2027
1.	Subvencionimi i fares së grurit dhe plehut artificial	20,000.00 €
2.	Subvencionimi i fares së misrit dhe plehut artificial	20,000.00 €
3.	Subvencionimi i fermerëve me sera prej 2 ari	50,000.00 €
4.	Subvencionimi i qumështit për litër	70,000.00 €
5.	Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor	20,000.00 €

❖ Në tabelat e më poshtme janë të paraqitura numri i përfituesve dhe shumat e shpenzuara sipas Gjinisë (Gra dhe Burra) për vitin 2023.

Tabela 1. Numri i Përfituesve nga Projektet për Gra dhe Burra nga projektet e realizuara nga viti 2023.

Nr.	Pershkrimi i Projekteve	Nr.Total i Përfitues.	Shqiptar	Serb / Rom	Numri i Përfitue. / Gra	Numri i Përfitue. / Burra	% Përfitues. / Gra	% Përfitues. / Burra	Shuma totale e projektëve në /€.
1	Farë Gruri dhe pleh artificial	48	47	1	1	47	2.08	97.92	13 138.25
2	Pjatore me 24 disqe	10	10	0	1	9	10	90	22
3	Kositëse bari rotative - 165 cm.	10	10	0	1	9	10	90	490.00
4	Subvencionim i qumështit për litër, 6M - 1 /2023	63	63	0	4	59	6.34	93.66	41 999.85
5	Subvencionim i qumështit për litër, 6M - 2 /2023	60	60	0	4	56	6.66	93.33	34 568.55
	TOTALI:	191	190	1	11	180			

Tabela 2. Shumat e shpenzuara nga Projektet për Gra dhe Burra nga projektet e realizuara nga viti 2023.

Nr.	Emërtimi i projekteve	Shumat e shpenzuara në - Gra / €.	Shumat e shpenzuara në - Burra / €.	Shuma e Projekteve / Gjithsejt në €.
1	Farë gruri dhe Pleh artificial	314.50	12 823.75	13 138.25
2	Mekanizëm Bujqësor	1 574.80	14 168.70	22 940.00
3	Qumësht për lit. - 6M -1	2 231.35	39 768.50	41 999.85
4	Qumësht për lit. - 6M -2	1 926.75	32 641.80	34 568.55
TOTALI :				112 646.65

TRENDET E FINANCIMIT 2025 DHE VLERËSIMET 2026-2027

Drejtoria ADMINISTRATA	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
Stafi	22	22	9	9	9
Paga dhe Meditja	117,689.18	137,000.00	65,000.00	65,000.00	65,000.00
Mallra dhe sherbime	8,118.45	29,700.00	32,000.00	42,000.00	50,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere	98,356.40	120,000.00	140,000.00	160,000.00	180,000.00
Shpenzime kapitale	197,781.25				
TOTALI	421,945.28	286,700.00	237,000.00	267,000.00	295,000.00

Burimet e Financimit				-	-	-
Grandet Qeveritare	352,539.58	286,700.00				
Te hyrat vetanake	69,405.70					

Analiza gjinore e LLogaritjes e Pagave për vitin 2025

	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Totali	Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra		Burra	Gra
400-600	€ 4	€ 3	25,228.32	19,334.04	44,562.36	56.61	43.39
600-1000		2	20,437.64		20,437.64	100.00	-
1000+							-
TOTALI	€ 6	€ 3	45,665.96	19,334.04	65,000.00	70.26	29.74

Tabela 1.1 Buxhet Administrates në vitin 2016

Buxheti Total	Stafi			Buxheti Total		Totali	Mes. e buxhetit për person:		% Shpenzimet për Burra	% Shpenzimet për Gra
	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra		Shpenzimet për Burra	Shpenzimet për Gra		
Shqiptarë	5	3	8	45,665.96	19,334.04	65,000.00	9,133.19	6,444.68	\$ 70.26	\$ 29.74
Serbë										
Romë										
TOTALI			0	45,665.96	19,334.04	65,000.00	#DIV/0!	#DIV/0!	70.26	\$ 4.00



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë

1. Misioni

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë ka për qëllim ndërtimin e kapaciteteve ekonomike të zonës lokale për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët, duke krijuar kushte të favorshme për bizneset lokale, promovuar potencialet për zhvillimin e turizmit dhe njëherit duke pasur një Diasporë shumë të fuqishme të shërbej në krijimin e urave lidhëse, përmes investimeve të Diasporës, me Komunën dhe qytetarët e saj.

Objektivat Kryesore :

Sektori: Qendra Komunale e Biznesit

1. Funksionimi i Qendrës Komunale të Biznesit duke ofruar shërbime efikase
Për të qenë funksional si sektor Qendra Komunale e Bizneseve duhet me jetë një udhëheqës dhe se paku dy punëtor pra duhet te plotësohet qendra komunale e biznesit me staf..

Sektori: Zhvillimi Ekonomik

- Përmirësimi i ambientit biznesor dhe tërheqja e investimeve të reja.
- Krijimi i qendrës për zhvillimin e sektorit privat- Ofrimi i Praktikes në punë për te rinjtë, studente, Rritja e mbështetjes financiare për praktikante
- Subvencioni i bizneseve për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara,
- Monitorimi, mbikëqyrja- menaxhimi e Parkut Teknologjik për shfrytëzimin e hapësirave ndarja e zyrave);
- Planifikimi dhe përpilimi I listave të pronave të paluajtshme të komunës per publikim për dhënie në shfrytëzim ne bashkëpunim me drejtorinë për prone.
- Implementimi dhe përmbushja e objektivave te parapara në Strategjinë për zhvillim ekonomik local- Përmes komisionit te monitorimit
- Rritja e Mbështetjes për biznese start up për gratë dhe të rinjtë; Grantet LOT1 Lot 2- 150.000 euro
- Organizmi i panairëve për promovimin e prodhimeve vendore
- Aktivitete të përbashkëta me drejtoritë për organizimin e ditëve te diasporës; DKRS
- Linjë e gjelbër për biznese të diasporës me administratën
- Subvencionimi i bizneseve ne panairë vendore dhe ndërkombëtare
- Event i fund vitit me biznese lokale donatore bashkëpunëtoare te ndryshëm

- Bashkëpunimi me agjencionet e ndryshme si APRK, AZHR, KIESA, ARBK qe ndërliohen niveli komunal me nivelin qendror.

Sektori: Turizmi

1. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe promovimi i prioriteteve dhe potencialeve te pasurive natyrore/nëntokësore të komunës.
2. Promovimi i potencialeve për zhvillimin e turizmit;
3. Vazhdimi i Shënjëzimit te shtigjeve malore për ecje dhe digjitalizimi i tyre;
4. Bashkëpunime me donatore për Realizimin e projekteve të turizmit;
5. Vendorsja e Hartave turistike ne tre lokalitete Brenda Komunës- Lugu I verdhe, Qytet dhe Roganë

Investimet Kapitale

- Ndërtimi i tregut të gjelbër në Kamenicë
- Mbarëvajtja e projektit të qendrës zejtare- Procedurat e dhënies ne shfrytëzim te lokaleve për bizneset qe merren me zejtari.
- Përgatitja e thirrjes publike për bashkëfinancim te adaptimit te objekteve komunale të pashfrytëzuara në bujtinave malore
- Lugu i verdhë
- Parku i aventurave

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

Zhvillimi Ekonomik:

- Takime me investitorë potencial, pjesëmarrja dhe promovimi i komunës ne panaire te ndryshme
- Takime me organizata vendore dhe ndërkombëtare për mundësit e bashkëpunimit në projektin e praktikës profesionale
- Mbikëqyrja mbi mbarëvajtjen e parkut teknologjik, bashkëpunimi me biznese/OJQ, për funksionalizimin e Parkut Teknologjik
- Bashkëpunimi me drejtorinë për pronë për përpilimin e pronave të lira komunale për shfrytëzim
- Monitorimi për zbatimin e objektivave për implementimin dhe zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal
- Mbështetja e bizneseve përmes granteve, trajnimeve, bashkëpunimeve me donatore në forma të ndryshme
- Bashkëpunimi me DKRS dhe DB për organizimin e ditëve të Diasporës
- Ofrimi i kushteve për pjesëmarrjen e bizneseve në panairin e promovimit të produkteve vendore
- Linjë e gjelbër për biznese të diasporës- Pako për diasporë
- Përgatitja e dokumentacionit te nevojshëm për financimin e pjesëmarrjes të bizneseve në panaire të ndryshme
- Mbledhja e donatoreve, qeverisë organizatave të ndryshme bashke me bizneset tona në eventin e fund vitit
- Rritjen e pjesëmarrjes së grave, të rinjve dhe grupeve të marginalizuara në tregun e punës;
- Forcimi i kapaciteteve të shërbimeve të punësimit dhe zgjerimin e shërbimeve të aftësimiit profesional.

- Organizimi i sesioneve informuese për thirrjet e ndryshme të komunës dhe ministrive të ndryshme;
- Nxitja e investimeve përmes avancimit të politikave, rregullatorit, rritjes së kapaciteteve të prodhimit dhe përpunimit në sektorët prioritar industrial, si dhe rritjes së hapësirës së zonave ekonomike;
- Gjenerimi i punësimit gjithëpërfshirës dhe më të mirë;
- Lehtësimi i industrisë së gjelbër dhe qarkore;
- Rritja e Inovacionit në Ndërmarrësi;

Sektori: Turizmi

- Identifikimi i shtigjeve të reja malore për ecje;
- Pjesëmarrja në panairë të ndryshme për promovimin e potencialit të komunës ;
- Huluntimi për thirrje/ aplikime të ndryshme në fushën e turizmit, huluntimi për bashkëpunime me donatorë të ndryshëm;
- Përfundimi i projektit të hartave turistike.

Investimet Kapitale

- Tregu i gjelbër- Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm, hartimi i projektit, inicimi i procedurave të prokurimit
- Mbarëvajtja e projektit të qendrës zejtare- Procedurat e dhënies në shfrytëzim të lokaleve për bizneset që merren me zejtarë.
- Përgatitja e thirrjes publike për bashkëfinancim të adaptimit të bujtinave malore
- Lugu i verdhë, bashkëpunimi me ministri/ organizata të ndryshme për realizimin e pjesëve të ndryshme të projektit, inicimi i procedurave të prokurimit
- Parku i aventurave- bashkëpunimi me ministri/ organizata të ndryshme për realizimin e pjesëve të ndryshme të projektit, inicimi i procedurave

Tabela e Buxhetit sipas viteve 2023-2027/ Drejtorisa e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporës

Trendet e Financimit 2025-2027

Drejtorisa ADMINISTRATA	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
Stafi	5	5	5	5	5
Paga dhe Meditja	37,930.89	43,000.00	43,000.00	45,000.00	50,000.00
Mallra dhe shërbime	25,679.86	40,150.00	40,000.00	42,000.00	45,000.00

Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere	69,914.89	108,000.00	170,000.00	170,000.00	170,000.00
Shpenzime kapitale		40,000.00			
TOTALI	133,525.64	231,150.00	253,000.00	257,000.00	265,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare	103,547.75	191,150.00			
Te hyrat vetanake	29,977.89	40,000.00			

Analiza gjinore e LLogaritjes e Pagave për vitin 2025

	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Totali	Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra		Burra	Gra
400-600	2	1	16,298.08	6,530.04	22,828.12	50.00	50.00
600-1000		2		20,171.88	20,171.88	-	100.00
1000+							
TOTALI	2	3	16,298.08	26,701.92	43,000.00	40.00	60.00

Buxheti Total	Stafi			Buxheti Total			Totali	Mes. e buxhetit për person:		
	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra			Shpenzimet për Burra	Shpenzimet për Gra	% Shpenzimet për Burra
Shqiptarë	2	3	5	16,298.08	26,701.92	43,000.00	8,149.04	8,900.64	\$ 37.90	\$ 62.10
Serbë										
Romë										
Të tjerë										



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA PËR KADASTËR GJEODEZI

DHE PRONË

Deklaratë e Vizionit:

Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër ka për qëllim planifikimin zhvillimor brenda drejtorisë. Bashkëpunon me drejtorinë e Urbanizmit dhe ofron të dhëna lidhur me mbikëqyrjen e çdo ndërtimi, jep ndihmë dhe ofron shënime kadastrale dhe gjeodezike për identifikimin e pronave në procedurë të rregullt juridike administrative. Është përgjegjëse për mirëmbajtjen e shënimeve kadastrale komunale mirëmbajtjen e planeve dhe hartave gjeodezike. Mbrojtjen dhe identifikimin e pronës së patundshme komunale, menaxhimin e shfrytëzimit të tokës komunale shpronësimin e pronës dhe mbrojtjen nga uzurpimet arbitrare dhe formave tjera. Bashkëpunon në mënyrë profesionale me Qeverinë e Kosovës MAPL, MMPH, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe me të gjitha drejtorit tjera Komunale.

Deklaratë e Misionit:

Zyra për Kadastër

Deklarata e Misionit: Është përgjegjëse për mirëmbajtjen e të gjitha shënimeve kadastrale aty ku përfshihen të gjitha pronat e patundshme të komunës.

Zyra për Gjeodezi

Deklarata e Misionit: Është përgjegjëse për matjet, regjistrimin e ndarjeve-nën ndarjeve (në parcela) sipas kërkesës së palëve-pronarëve.

Zyra për Pronësi

Deklarata e Misionit: Është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të uzurpimeve të pronës zhvillon procedura për shpronësim në interes të përgjithshëm komunal.

Deklarata e Qëllimit:

Realizimi sa ma efikas i këtyre detyrave sipas deklaratës së vizionit

Objektivat Kryesore :

- Azhurimi
- Mirëmbajtja e operatit kadastral
- Efikasiteti
- Realizimi i të hyrave sipas parashikimit
- Mbrojtja e pronës publike nga uzurpatorët.

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

- Procedurat e shpronësimeve (mjete të veçanta)
- Mirëmbajtja e teknologjisë informative
- Punët në teren për kërkesa tre Komunës – drejtorive
- Trajtimi i rasteve të uzurpimeve të pronës publike
- Rritja e stafit të drejtorisë edhe për dy (3) punëtorë pas pensionimit të stafit.
- Sektori i Pronësisë një (1) Jurista
- Sektori i Kadastrit një Gjeodet përpunim i lendeve
- Furnizim me kompjuter dhe material përcjellës(tonerë)
- Furnizim për zyre (material hargjues)
- Udhëtimet zyrtare,
- Mirëmbajtja e zyrave dhe sistemit të ngrohjes

TRENDET E FINANCIMIT PER VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET 2026-2027

Drejtoria ADMINISTRATA	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
Stafi	11	11	11	12	12
Paga dhe Meditja	71,104.23	77,000.00	75,000.00	89,000.00	90,000.00
Mallra dhe sherbime	14,712.47	11,000.00	15,000.00	20,000.00	20,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale			20,000.00	50,000.00	50,000.00
TOTALI	85,816.70	88,000.00	110,000.00	159,000.00	160,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-

Grandet Qeveritare	85,816.70	88,000.00			
Te hyrat vetanake	-				

Analiza gjinore e LLogaritjes e Pagave për vitin 2025

	Stafi		Pjesemarrja ne buxhet		Totali	Pjesemarrja ne %	
	Burra	Gra	Burra	Gra		Burra	Gra
400-600	3	3	17,722.00	18,247.32	35,969.28	49.27	50.73
600-1000	3	1	28,472.40	10,558.32	39,030.72	72.95	27.05
1000+					-	-	-
TOTALI	6	4	46,194.36	28,805.64	75,000.00	61.59	38.41

Buxheti Total	Stafi			Buxheti Total			Totali	Mes. e buxhetit për person:			
	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra			Shpenzimet për Burra	Shpenzimet për Gra	% Shpenzimet për Burra	% Shpenzimet për Gra
Shqiptarë	6	4	10	46,194.36	28,805.64	75,000.00	7,699.06	7,201.41	61.59	38.41	
Serbë											
Romë											
Të tjerë											



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Drejtor – Uran Berisha

Misioni:

Misioni i drejtorise se Urbanizmit dhe Planifikimit Hapesinor eshte te orientoj dhe mbaje nen kontrolle zhvillimin hapesine ne teritorin e komunes se Kamenices, duke bere hartimin e dokumenteve te planifikimit hapesine, zbatimin e tyre gjate trajtimit te kerkesave per leje ndertimore, si dhe te zhvilloj/permiresoj infrastrukturen teknike dhe sociale permes planifikimit, zbatimit dhe kontrollimit te investimeve kapitale.

Situata aktuale:

Duke pasur parasysh planifikimet buxhetore te viteve te kaluara ne DUPH kemi kete situatë:

- Gjat vitit 2023 kemi draftuar Planin Zhvillimor Komunal, deri me tani kemi arritur ta bejme draftimin dhe dorezimin ne MMPHI per te mare pelqimin per shqyrtim publik te PZHKse, nga MMPHI na kane kerkuar ta revidojme draftin e PZHKse dhe ta harmonizojme me kerkesat ligjore. Per kete kemi angazhuar konsulent/ekspertët te jashtëm te planifikimit hapësinor.
- Sa i perket Hartes Zonale, mujin e kaluar kemi derguar kerkesen ne Kuvend te Komunes per iniciimin e procedurave per hartim te HZKse, kuvendi ka miratuar kerkesen, dhe po presim ligjeshmerine e vendimit te kuvendit qe te vazhdojme gjate ketij viti te punojme per hartimin e HZKse.
- Nuk kemi mundur te vazhdojme me hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, per shkak qe sipas ligjit te planifikimit hapesine, se pari hartohet HZK, pastaj vazhdohet ne hartim te Planeve te Hollësishme.
- Rritje prej 72% e te hyrave nga taksat ndertimore dhe te infrastruktures ne raport me te hyrat e vitit 2022, ku jane inkasuar gjithsejt **81,936.75 euro**.
- Kemi bere hartimin, menaxhimin e kontratave të investimeve kapitale, ku per hartim te projekteve kemi angazhuar Operator Ekonomik projektues, por edhe konsulent individual te jashtem per hartim dhe menaxhim te projekteve, por kemi angazhuar edhe inzhinjeret e DUPH-së, per hartim dhe menaxhim te projekteve.

VIZIONI per te ardhmen eshte te mbaje nen kontrolle zhvillimin hapesine ne teritorin e komunes se Kamenices, duke bere zbatimin e dokumenteve te planifikimit hapesine, si dhe planifikimin, zhvillimin, kontrollimin dhe zbatimin e projekteve te investimeve kapitale.

Ky vision synohet te arrihet permes 3 objektive kryesore per vitet 2025-2027:

- a) **Kompletimi i dokumenteve te planifikimit hapesine per teritorin e Komunes se Kamenices**
- b) **Permiresimi i infrastruktures teknike dhe sociale permes investimeve kapitale.**
- c) **Permiresimi i sherbimeve ne DUPH.**

Aktivitetet:**a) Kompletimi i dokumenteve te planifikimit hapesor per teritorin e Komunes se Kamenices, do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:**

-Keto dokumente planifikojme ti hartojme permese angazhimit te ekspertëve të jashtëm-konsulences, gjate viteve 2024,2025,2026,2027

DUPH	Viti 2024 Buxhetuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar	Viti 2027 Vlerësuar	Total Kosto e vleresuar e projektit	Menyra e financimit
Përfundimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartimi i Hartës Zonale të Komunës	30,000.00	30,000.00			60,000.00	Komuna
Hartimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme për zonat me interes të Komunës,		30,000.00	60,000.00	60,000.00	150,000.00	Komuna
TOTALI	30,000.00	60,000.00	60,000.00	60,000.00	210,000.00	

b) Permiresimi i infrastruktures teknike dhe sociale permes investimeve kapitale, do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:**1- Projektimi, mbikeqyrja dhe ndertimi apo asfaltimi i rrugeve dhe infrastruktures percjellese ne teritorin e komunes se Kamenices**

DUPH	Viti 2024 Buxhetuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar	Viti 2027 Vlerësuar	Total Kosto e vleresuar e projektit	Menyra e financimit
-Ndertimi i rrugeve lokale dhe infrastruktures percjellese neper qytet dhe fshatra.	934,974.00	1,750,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00	4,684,974.00	Komuna
-Ndertimi i rruges qarkore te qytetit	200,000.00	255,000.00	200,000.00	200,000.00	855,000.00	MMPHI
-Ndertimi i parkingut mbrapa QPSse		100,000.00			100,000.00	Komuna
-Zgjerimi i rruges nga ura afer Gjinnazit ne drejtim te		90,000.00	10,000.00		100,000.00	Komuna

stadiumit te qytetit						
-Zgjerimi i rruges nacionale qe lidhe Kamenicen me kyqjen ne autoudhen Prishtine-Dheu i bardhe		200,000.00	2,300,000.00	2,200,000.00	4,700,000.00	MMPHI
-blerja se 1 veture per dalje ne teren.		20,000.00				Komuna
TOTALI	1,134,974.00	2,415,000.00	3,510,000.00	3,400,000.00	10,439,974	

-Permiresimi i efijences energjetike neper objektet publike dhe rezidenciale

DUPH	Viti 2024 Buxhetuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar	Viti 2027 Vlerësuar	Total Kosto e vleresuar e projektit	Menyra e financimit
Hartimi i projektit kryesor dhe ndertimi i sistemit te ngrohjes qendrore ne qytet		50,000.00	950,000.00	1,000,000.00	2,000,000.00	Komuna Donatore tjere
Rritja e performances energjitike te objekteve te banimit kolektiv ne qytet, permes inestimeve ne izolime, etj			200,000.00	300,000.00	500,000.00	Komuna Donatore tjere
TOTALI		50,000.00	1,150,000.00	1,300,000.00	2,500,000.00	

c) Permiresimi i sherbimeve ne DUPH,

- Angazhim i konsulenteve te jashtem per hartim dhe menaxhim te projekteve/kontratave
- Trajnim per informim te stafit me ndryshimet ligjore ne aspektin e planifikimit hapesinor, ndryshimet ligjore ne aspektin e ndertimit, perdorim te softvereve GIS, etj.
- Vizita studimore, workshope me komuna te vendeve fqinje apo te BE-se, per shkembim te pervojave, etj.
- Kete planifikojme ta arrijme duke kontraktuar sherbimet e konsulences, per trajnim te stafit, dhe kontraktim te sherbimeve te akomodimit per vizita dhe workshope, gjate viteve 2025,2026,2027

- Permiresimi i sherbimeve ne DUPH

DUPH	Viti 2024 Buxhetuar	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar	Viti 2027 Vlerësuar	Total Kosto e vlerësuar e projektit	Menyra e financimit
Angazhim i konsulentëve të jashtëm për hartim dhe menaxhim të projekteve/kontratave		35,000.00	35,000.00	35,000.00	105,000.00	Komuna
- Trajnime, vizita studimore, workshope		5,000.00	5,000.00	5,000.00	15,000.00	Komuna
TOTALI		40,000.00	40,000.00	40,000.00	120,000.00	

TABELA E PERMBLEDHUR E BUXHETIT AKTUAL DHE TE PLANIFIKUAR:

URBANIZMI	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
Stafi	12	12	10	10	10
Paga dhe Meditja	76,357.53	95,000.00	95,000.00	95,000.00	95,000.00
Mallra dhe shërbime	29,868.97	99,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale	596,823.60	1,194,974.00			
TOTALI	703,050.10	1,388,974.00	145,000.00	145,000.00	145,000.00
Burimet e Financimit			-	-	-

Grandet Qeveritare	603,198.50	1,218,974.00			

PROJEKTET QË JANË INICUAR NGA DUPH:

- Hartimi i projekteve LOT 1 dhe LOT 2**, në realizim e siper.
- “Ndërtimi i rrugëve me asfalt në qytet dhe fshatra dhe mbushja e gropave”**, Projekt në realizim e siper.
- “Ndërtimi i trotuarëve në qytet dhe fshatra”**, projekt i perfunduar”
- “Ndërtimi i urave metalike/beton për këmbësor”**, Projekt në realizim.
- “Ndërtimi i urave të vogla nga betoni,zgjerimi dhe riparimi i urave egzistuese”**, Projekt në realizim.
- “Ndërtimi i parqeve në Kamenice - parku të amfiteatri i bulevardi, parku te qendra e vjetër”** Projekt në realizim.
- “Renovimi i ndërtesës sociale në Kamenicë”**. Projekt në realizim e siper.
- “Sherbimet e konsulences – Konsulent, ekspert per vleresimin strategjik mjedisor”** të planit zhvillimor komunal. Kontrate e perfunduar.
- “Ndërtimi i bulevardit te Qytetit ne Kamenicë”**-punë të mbetura, OE. nuk eshte treguar serioz, dhe punet nuk jane realizuar sipas kontrates.

Arsyetim:

- Rritja e vleres se planifikuar per investime kapitale, ndodhe sepse kemi perfshire edhe projektet qe tashme i kemi ne marveshje me ministrite perkatese, si dhe vjen si rrjedhoje e planifikimit jo te mire te vleres se investimeve kapitale per vitin 2024, ku ne perlllogaritjet fillestare kemi parashikuar vetem vleren e asfaltimit te rrugeve lokale, por jo edhe te infrastruktures percjellese nentokesore.
- Prandaj si komune kemi vendosur qe gjate planifikimit dhe implementimit te investimeve, sidomos asfaltimeve te rrugeve lokale, ti kushtojme rendesi qe para se te asfaltohen rruget, te investohet fillimisht ne infrastrukturen nentokesore, si: ujesjelles, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, instalimet elektrike, etj. Kjo vjen si rrjedhoje e synimit te eliminimit te praktikave jo te mira te meherishme, ku ka ndodhur qe komuna fillimisht te investoj ne asaltim, duke i anashkaluar infrastrukturen nentokesore, ku pastaj eshte dashur te demolohet asfalti per te investuar ne infrastrukturen nentokesore.
- Nje arsye tjeter qe ka ndikuar ne rritjen e vleres se parashikuar te invesimeve kapitale eshte nevoja urgjente per investime ne kanalizimin e ujerave atmsoferike (te hapura dhe te mbyllura), qe po shtohet gjithnje e me teper si pasoje e ndryshimeve klimatike Sic mund te jeni informuar, njera nder efektet me te cilat po manifestohen ndryshimet klimatike eshte edhe reshjet dhe vershimet e befasishme, te cilat po shkaktojne deme ne infrastrukturen publike ekzistuese.
- Vlene te ceket qe arsye shtese e rritjes se shumes e planifikuar per investime kapitale eshte edhe rritja e cmimeve te punes dhe materialit ndertimor.



Drejtoria e Investimeve Kapitale

Deklarata e misionit:

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive që ka:

- harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm të infrastrukturës në nivel të komunës, në përputhje dhe në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe në harmoni me zhvillimin urbanistik të vendbanimeve dhe viseve rurale;
- përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore;
- përgatit detyrat projektuese dhe bën kategorizimin e objekteve të infrastrukturës lokale dhe rurale.

Deklarata e qëllimit:

- Harton projektet e vogla të infrastrukturës, sipas kërkesave të bashkësive lokale;
- lëshon leje për ndërtim (të infrastrukturës rrugore) dhe leje për gropim dhe hapje të kanaleve, të cilat i bëjnë ndërmarrjet publike, si dhe leje për kyçje individuale të qytetarëve në rrjetin e infrastrukturës;
- është përgjegjëse për menaxhimin (mbikëqyrjen) e ndërtimit, rindërtimit dhe sanimit të infrastrukturës rrugore (kanalizimet fekale, atmosferike, kabllore, ujësjellësin, asfaltimin, ndriçimin publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal) në qytet dhe vise rurale;
- kontrollon dhe mbikëqyrë cilësinë dhe ngjeshmërinë e materialit ndërtimor, nëpërmjet laboratorit të licencuar për përputhshmërinë me norma teknike të pranuar në nivel ndërkombëtar dhe të BE;
- bashkëpunon me organin e prokurimit, me qëllim të jetësimit të kontratave të nënshkruara për kryerjen e punimeve të infrastrukturës lokale;
- kryen punë nga lëmi i gjeodezisë për nevoja të Drejtorisë;
- ruan dokumentacionin e eksproprijimit të pronave gjatë viteve të mëhershme që janë në interes të Komunës;
- arkivon dokumentacionin teknik të infrastrukturës lokale.

Investime Kapitale	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
Stafi			6	6	6
Paga dhe Meditja			55,000.00	60,000.00	60,000.00
Mallra dhe shërbime			50,000.00	50,000.00	50,000.00
Shpenzime komunale					

Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale			1,038,818.00	1,177,043.00	1,958,824.00
TOTALI	-	-	1,143,818.00	1,287,043.00	2,068,824.00
Burimet e Financimit			-	-	-
Grandet Qeveritare					
Te hyrat vetanake					



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



ADMINISTRATA -SHËNDETËSI

A A.Ndërlidhja e Prioriteteve e Strategjike me Procesin Buxhetor

1. Misioni

Të prezentohet misioni i organizatës buxhetore

Misioni i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:

Sigurimi i zbatimit të kujdesit parësor shëndetësor, duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese, nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, si dhe brenda synimeve të politikave shëndetësore të siguroj ofrimin e shërbimeve shëndetësore kualitative, mbikëqyrë situatën epidemiologjike ne nivel komunal, si dhe përkujdesjen për mirëqenie sociale të kategorive te caktuara të popullatës së saj.

2.Situata Aktuale

Të përshkruhet situata aktuale ,(të arriturat e vititi 2023),implementimi i objektivave të KASH 2025-2027,si dhe sfidat e përmbushjeve dhe arritjen e objektivave të planifikuara për vitin 2023

- **Renovimi i dy (2) AMF-ve (Topanicë dhe Busavatë);**
- **Rritja e buxhetit për sigurimin e barërave esenciale;**
- **Realizimi i kontrollave sistematike (nxënësit nga klasa I-rë deri në klasën e IX-të);**
- **Shpërndarja e pakove higjienike për nxënësit nga klasa I-rë deri në klasën e IX-të.**

3.Objektivat dhe Aktivitetet

Të identifikohen /azhurnohen dhe të prezentohen objektivat kryesore të organizatës buxhetore që kanë si qëllim arritjen e misionit të organizatës buxhetore duke i ndërlidhur me dokumentet strategjike.Të identifikohen maksimum deri në 3 objektiva dhe të përshkruhet secili objektivi shkurtimisht.Të identifikohen për secilin objektivi 2 deri në 3 aktivitete specifike afatmesme,dhe për secilin aktivitet të ofrohet indikator i performancës,si dhe caqet vjetore për këta indikatorë në periudhën 2025-2027

4.Trendet e Financimit 2025 dhe vlerësimet 2026-2027

Të prezentohet një tabelë e shpenzimeve (shpenzimi 2023, Buxheti 2024) dhe kufijt e vlerësuar 2025-2027 të ndarë sipas kategorive të shpenzimeve dhe burimeve të financimit në nivel të organizatës buxhetore

5.Propozimet për Politika të reja 2025-2027

Të prezentohet një tabelë e propozim politikave të reja të cilat janë të ndërlidhura me Dokumente Strategjike si dhe politikat e miratuara të Qeverisë të ndarë sipas kategorive të shpenzimeve dhe burimeve të financimit në nivel të Organizatës Buxhetore .

- 1. Ndarja e Urgjencës nga Mjekësia Familjare;**
- 2. Qendra për të moshuar;**
- 3. Banimi social dhe i përballueshëm**
- 4. Strehimi familjar dhe Strehimoret**

Objektivat Kryesore :

- Ndarja e Urgjencës nga Mjekësia Familjare;
- Sigurimi i barërave për pensionistët;
- Renovime dhe përmirësime infrastrukturore në objektet e njësive të DShMS-së;
- Sigurimi i Ujit cilësor;
- Realizimi i kontrollave sistematike për nxënës/sigurimi i pakove higjienike për nxënës;

- Trajtime specialistike dhe psikologjike në kuadër të DShMS-së;
- Paisja e institucioneve të Komunës së Kamenicës me pako për ofrimin e ndihmës së parë;
- Promovimi i banimit social, të përballueshëm dhe strehimit familjar/strehimoreve;
- Realizimi i fushatave sensibilizuese dhe shënimin e ditëve ndërkombëtare në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Qendra për të moshuar;
- Shërbime cilësore-shëndetësore;
- Shërbimeve cilësore-sociale dhe familjare.

-Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve:

- Formimi i ekipeve të Urgjencës;
- Shtimin e numrit të mjekëve;
- Modifikimi/përshtatja e hapësirës;
- Shqyrtimi i mundësive për objekt të ri;
- Zgjerimi i listës së barërave e cila do të bëhet në koordinim dhe bashkëpunim me profesionistët shëndetësor të QKMF-së, duke u bazuar në nevojat që kanë kjo kategori.
- Rrënimi i objektit të vjetër të RTG (pas përfundimit të procesit të asgjësimit të barërave);
- Përmirësimi i hapësirave të Parkingut në QKMF;
- Bashkëpunim me QRShP-Gjilan;
- Realizimi i kontrollave të ujit në institucionet e komunës;
- Realizimi i kontrollave sistematike ku do të përfshihen të gjithë nxënësit parafillorë dhe prej klasave 1, 5 dhe 9;
- Vlerësimi i aftësive të përgjithshme, komunikative si dhe psiko-sociale;
- Përditësimi i databazës për regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave nga kontrollat sistematike për secilin nxënë;
- Ofrimi i seancave këshilluese dhe trajtuese nga Psikologu klinik;
- Identifikimi i institucioneve të cilat nuk kanë pako për ofrimin e ndihmës së parë;
- Identifikimi i institucioneve të cilat nuk kanë pako për ofrimin e ndihmës së parë;
- Fushata sensibilizuese për mundësitë e krijuara nëpërmjet projektit të banimit të përballueshëm;
- Hulumtime në teren, lidhur me nevojat e qytetarëve për banim social, të përballueshëm dhe strehim;
- Mbështetja e strehimoreve me financim të vazhdueshëm;
- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese të shëndetit sipas kalendarit të OBSH-së për Ditët ndërkombëtare;
- Organizim i aktiviteteve për parandalimin e dukurive negative; fushata kundër dhunës në familje, etj;
- Aktivitetet do të plotësohen me angazhime shtesë sipas nevojës dhe kërkesave nga bashkëpunimi me IKShP dhe në zbatim të Planit të Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2023-2025 në kuadër MSh-së;
- Shqyrtimi i mundësive buxhetore për ndërtimin e një (1) Qendre për të moshuar;
- Planifikimi buxhetor për Qendrën për të moshuar;
- Shqyrtimi i hapësirave aktuale për mundësinë e ridestinitimit dhe përshtatjes për Qendrën për të Moshuar (Konvikti i nxënësve);
- Zgjerimi i vizitave në shtëpi nëpër lokalitete;

- Përmirësimi i shërbimeve të vaksinimit për popullatën, me theks tek grupet e cënueshme të shoqërisë;
- Furnizim me paisje të reja dhe inovative për trajtime shëndetësore;
- Furnizimi me barëra dhe paisje të tjera të domosdoshme në QKMF, QMF dhe AMF-të;
- Marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Regjional, për ofrimin e shërbimit të PAP-testit në QKMF;
- Sigurimi i një (1) Autoambulance;
- Mbështetja për pavarësim financiar për viktimat e dhunës në familje;
- Pilotimi i programeve të këshillimit paramartesor;
- Këshillimi për prindërimin pozitiv;
- Hartimi i Planit të Punës së Ekipës për të Drejtat e Fëmijëve në Komunë;
- Shqyrtimi i Rekomandimit të MMPHI-së për themelimin e Sektorit të Banimit Social;
- Propozimi nga DShMS-ja për themelimin e Sektorit të Banimit Social.

ADMINISTRATA-SHENDETESI	Viti 2023 Shpenzuar	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	2026 Vlerësuar	2027 Vlerësuar
	4	4	4	4	4
Paga dhe Meditja	30,519.78	31,000.00	33,000.00	33,000.00	33,000.00
Mallra dhe shërbime	26,192.85	41,250.00	45,000.00	45,000.00	50,000.00
Shpenzime komunale					
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale	11,230.90	20,000.00	40,000.00		
HARTA E RRJETIT RRUGOR NË KOMUNËN E KAMENICËS



LEGJENDA

- KOMUNA
- Zonat_Kadestrate_të_Dardanisë
- - - Rrugët_Asfaltuara
- Rrugët_Regjionale

1 centimetër = 100,000 centimetra

Në tabelën e më poshtme do të paraqesim të gjitha rrugët në qytetin e Kamenicës, kodin e rrugës si dhe gjatësinë e tyre, të cilat i kanë edhe tabelat me emrat përkatës të rrugëve.

Nr.	Vendbanimi	Kodi i rrugës	Emri i rrugës	Gjatësia e rrugës me të gjitha segmentet (m)
1	Kamenicë	10_10040	Abdyl Frashëri	448.84
2	Kamenicë	10_10051	Agush Isufi	245.70
3	Kamenicë	10_10579	Ajet Kosovica	118.64
4	Kamenicë	10_10017	Ali Hadri	574.91
5	Kamenicë	10_10019	Ali Huruglica	174.70
6	Kamenicë	10_10059	Arbëria	95.11
7	Kamenicë	10_10403	Arbreshët	114.78
8	Kamenicë	10_10050	Azem Bejtë Galica	183.76
9	Kamenicë	10_10054	Bajo Topulli	188.78
10	Kamenicë	10_10006	Basri Canolli	358.78
11	Kamenicë	10_10410	Besa e Kuqe	144.17
12	Kamenicë	10_10056	Besnik Maroca	1,523.59
13	Kamenicë	10_10068	Beteja e UÇK Mareci	137.05
14	Kamenicë	10_10037	Celulat e UÇK	962.33
15	Kamenicë	10_10578	Çerçiz Topulli	108.44
16	Kamenicë	10_10406	Dallmatia	91.82
17	Kamenicë	10_10024	Dardania	276.70
18	Kamenicë	10_10074	Dedë Gjon Luli	164.19
19	Kamenicë	10_10023	Dëshmorët e Kikës	612.44
20	Kamenicë	10_10046	Dëshmorët e Kombit	974.28
21	Kamenicë	10_10031	Ilir Konushevi	687.84
22	Kamenicë	10_10034	Elena Xhika	156.17
23	Kamenicë	10_10007	Fehmi Agani	268.16
24	Kamenicë	10_10577	Filati	84.35
25	Kamenicë	10_10053	Florim Imeri	147.36
26	Kamenicë	10_10115	Florim Kosumi	113.93
27	Kamenicë	10_10062	Hafiz Ali Korqa	351.71
28	Kamenicë	10_10028	Hasan Jakupi	600.57
29	Kamenicë	10_10003	Hasan Prishtina	2,233.14
30	Kamenicë	10_10081	Hasan Tërpeza	172.27
31	Kamenicë	10_10018	Iliria	714.97
32	Kamenicë	10_10027	Ismail Ismajli	416.80
33	Kamenicë	10_10057	Kalabria	176.99
34	Kamenicë	10_10026	Komandat Gaca	377.23
35	Kamenicë	10_10025	Kongresi i Manastirit	218.10
36	Kamenicë	10_10035	Korfuzi	523.60
37	Kamenicë	10_10065	Labëria	116.74
38	Kamenicë	10_10072	Lam Breznica	147.28
39	Kamenicë	10_10043	Liburnia	225.34
40	Kamenicë	10_10016	Lot Vaku	582.01
41	Kamenicë	10_10071	Beteja e Kikës	599.46
42	Kamenicë	10_10063	Beteja e Ushit	746.43
43	Kamenicë	10_10010	Marigona	182.12

44	Kamenicë	10_10014	Mbreti Agron	167.42
45	Kamenicë	10_10064	Mbreti Bardh	151.33
46	Kamenicë	10_10045	Mbreti Gent	177.00
47	Kamenicë	10_10013	Mbretëresha	144.89
48	Kamenicë	10_10361	Mic Sokoli	733.20
49	Kamenicë	10_10030	Mici e Toni	833.91
50	Kamenicë	10_10029	Mihajl Grameno	281.49
51	Kamenicë	10_10066	Mollosët	262.10
52	Kamenicë	10_10002	Muharrëm F Kastrati	1,121.06
53	Kamenicë	10_10402	Mulla Idriz Gjilani	220.88
54	Kamenicë	10_10363	Musli Imeri	1,728.64
55	Kamenicë	10_10004	Tahir Sinani	1,052.82
56	Kamenicë	10_10044	Nexhmedin Kuçi	932.52
57	Kamenicë	10_10067	Nuhi Berisha	236.77
58	Kamenicë	10_10052	Oso Kuka	94.10
59	Kamenicë	10_10060	Pirroja	77.57
60	Kamenicë	10_10036	Preveza	241.67
61	Kamenicë	10_10032	Futoshka	214.62
62	Kamenicë	10_10047	Abetares	281.36
63	Kamenicë	10_10405	Kulina	221.64
64	Kamenicë	10_10009	Doruntina	340.30
65	Kamenicë	10_10001	Skënderbeu	850.34
66	Kamenicë	10_10033	Sahit Baliq	208.52
67	Kamenicë	10_10022	Sali Çeku	501.28
68	Kamenicë	10_10055	Sali Gjyrisheci	129.23
69	Kamenicë	10_10041	Sef Kosharja	420.72
70	Kamenicë	10_10048	Shote Galica	118.87
71	Kamenicë	10_10049	Shyt Mareci	147.32
72	Kamenicë	10_10005	Syl Zarbica	1,152.58
73	Kamenicë	10_10042	Sylejman Vokshi	408.53
74	Kamenicë	10_10012	Nëna Terezë	402.76
75	Kamenicë	10_10058	Taulantët	120.49
76	Kamenicë	10_10404	Udha e Shkronjave	165.79
77	Kamenicë	10_10008	Vëllezërit Bytçi	797.66
78	Kamenicë	10_10080	Vëllezërit Frashëri	504.37
79	Kamenicë	10_10079	Vëllezërit Krivaça	296.73
80	Kamenicë	10_10011	Vlora	158.17
81	Kamenicë	10_10039	Vudro Wilson	339.92
82	Kamenicë	10_10362	Xhaxhi	1,084.45
83	Kamenicë	10_10073	Ymer Prizreni	147.81
84	Kamenicë	10_10038	Zukë Leci	244.95
TOTALI				35,057.36 m

Gjatësia e përgjithshme e rrugëve vetëm në qytetin e Kamenicës është 35,057.36 m ose 35.06km.

7. TRANSPORTI LOKAL, LINJAT URBANE DHE URBANE-PERIFERIKE

Transporti ndër-urban i udhëtarëve bëhet për mes linjave të rregullta nga transportuesit privat. Lidhur me transportin lokal publik komuna ka planifikuar dy veprime për realizimin e nevojave të qytetarëve. Në rastin e parë Drejtoria e Shërbimeve publike, Ambientit dhe Inspektoratit çdo vit bën shpalljen publike për operatorët transportues që të aplikojnë për marrjen e linjave urbane dhe urbane- periferike. Ndërsa në rastin e dytë gjithashtu edhe zyra e prokurimit i kryen procedurat për bartjen e nxënësve të cilët jetojnë në lokalitete ku ata janë larg shkollave. Në komunën e Kamenicës janë 41 lokalitete të cilat janë të përfshira me transport nga operatorët transportues privatë, ku në total janë gjithsejtë 58 lokalitete. Për 17 vende të pa mbuluara me transport nuk kemi pasur kërkesa, pasi kryesisht ato vende janë kodrinore malore dhe nuk ka frekuentim të madh të banorëve.

8. VEND -PARKINGJET

Në qytetin e Kamenicës janë 20 vend parkingje publike, ndërsa në të gjitha këto janë 946 vende për parkim. Gjithashtu janë edhe 68 vend parkime për Taxi. Numri i parkingjeve në vend parkime për persona me aftësi të kufizuara është 22. Në lokalitete tjera jashtë qytetit ka edhe vende tjera publike dhe private për parkimin e automjeteve, por që nuk janë të rregulluara sipas standardeve. Pas themelimit të ndërmarrjes publike lokale e cila veç është duke u finalizuar, planifikohet që të gjitha parkingjet të menaxhohen nga NPL "DARDANA".


9. INFRASTRUKTURA RRUGORE

Pozita gjeografike e Komunës së Kamenicës është periferike në skajin më lindor të Kosovës, por është urë lidhëse në mes të Kosovës dhe komunave të Serbisë Jugore kryesisht të banuara me shqiptar. Komuna e Kamenicës shtrihet në regjionin e Anamoravës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike sidomos për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit. Territori i kësaj komune zë një sipërfaqe prej 417 km². Nëpërmjet magjistrales Gjilan-Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Stacioni më i afërt Hekurudhor është në Ferizaj dhe Bujanoc. Lidhjet ajrore më të afërta me Kamenicën janë aeroporti i Prishtinës "Adem Jashari" me lagësi 90 km dhe ai i Shkupit 130 km.

Gjatësia e të gjitha rrugëve (të kategorizuara dhe të pa kategorizuara) në territorin e komunës së Kamenicës është rreth 586 km. Gjatësia e rrugëve regjionale në territorin e komunës së Kamenicës është 112 km, ndërsa gjatësia e rrugëve lokale është 474 km. Në tabelën e më poshtme do ti paraqesim gjatësinë e rrugëve regjionale sipas lokaliteteve ku shtrihen rrugët.

Kodi i rr.	Segmenti rr.1	2	3	4	km
R 123	Crep	Kamenicë			9
R 123	Kamenicë	Busavatë	Boston		18
R 123(a)	Kamenicë	Strezoc	Krilevë	Glllogovicë	20
R 2161	Kamenicë	Tugjec	Kapi		24
R 124	Dheu i bardhë	Shipashnicë			11,5
R 134	Shipashnicë	Desivojcë	Tërstenë		16,5
R 215	Shipashnicë	Hogosht			7
R 214	Rogaqicë	Karavevë	Muhoc		6
TOTALI					112 km

Në vijim do të paraqesim Hartën e rrugëve regjionale në komunën e Kamenicës.



Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës dhe kufizohet në:

- Jug-Perëndim me komunën e Ranillugut;
- Perëndim me komunën Novobërdës;
- Veri-Perëndim me Prishtinën;
- Veri me Komunën e Medvegjës dhe Leskovcit;
- Lindje me Vrajën; dhe
- Lindje dhe Jug-Lindje me Bujanocin.

Territori i komunës së Kamenicës është territor kodrinor malorë me disa lugina rreth lumenjve me tokë aluviale shumë të përshtatshme për pemëtari dhe kultura tjera bujqësore. Këto lloje të tokave shtrihen në pellgun e lumenjve: Lumi i Kamenicës (ish Krivareka), Lumi i Hogoshtit dhe Lumi i Desivojces.

Shprehur në përqindje territori i komunës së Kamenicës 60% është kodrinor malorë dhe 40% i rrafshët. Lartësia më e ulët mbidetare është 380 m te “Dheu i Bardhë”, kurse ajo më e lartë është 1223 m te “Guri i Zi”.

9.1 Rrugët - Në komunën e Kamenicës (në zonat urbane dhe në vendbanimet rurale), nga gjithsej 474 km rrugë lokale, prej tyre të asfaltuara janë 263,80 km. Vetëm në zonat urbane të komunës janë 35,20 km rrugë. Nga totali i rrugëve, 221,5 km mirëmbahen nga organet komunale (sezoni veror dhe dimëror).

9.2 Infrastruktura përcjellëse e rrugëve - me trotuar, në zonat urbane dhe në vendbanimet rurale janë gjithsej në total 22,56 km.

Me ndriçim publik në total janë të pajisura 101,26 km rrugë, ndërsa rrugë me sinjalizim vertikal dhe horizontal janë 80 km.



10. TRANSPORTI PUBLIK


Në komunën e Kamenicës operojnë 8 kompani transportuese me autobusë të cilat nuk mundë ti mbulojnë të gjitha vijat e nevojshme urbane dhe urbane – periferike, andaj operojnë edhe disa operator të tjerë me auto kombi të cilat i mbulojnë linjat e kërkuara. Ndërsa linjat tjera ndër komunale po ashtu mbulohen nga disa kompani transportuese nga komuna e Kamenicës dhe disa nga komunat tjera.

Operatorët që ushtrojnë veprimtarinë për Taksi shërbime janë 4 kompani të taksive si dhe rreth 80 taksi individual që gravitojnë brenda territorit të Komunës. Numri i Taksive individuale është në rritje e sipër nga viti në vit.

Numri i vendndalimeve për automjetet e transportit në tërë territorin e komunës së Kamenicës është 62 vende. Nga këto vendndalime 15 prej tyre janë të pajisura me shenjëzim përkatës. Pjesa dërmuese e këtyre vendndalimeve janë në rrugët regjionale dhe është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës vendosja e sinjalizimit përkatës. Komuna ka planifikuar dhe ndarë buxhetin për realizimin e projektit për rregullimin e pritoreve për autobus. ku në Topanicë janë rregulluar dy, ndërsa një në Kamenicë. Është planifikuar që edhe në këtë vit të vazhdohet me rregullimin e pritoreve në lokalitete tjera të komunës së Kamenicës.

Numri i lokaliteteve të përfshira nga operatorët transportues, duke llogaritur edhe numrin e vijave ndër komunale, janë gjithsejtë 41 lokalitete nga 58 sa janë në total. Për 17 lokalitete tjera kryesisht vende kodrinore malore, nuk ka pasur kërkesa, pasi edhe ka një frekuentim shumë të vogël të qytetarëve.

Transporti publik do të vazhdojë të ofrojë shërbim nga operatorët privatë, sidomos në drejtim të zonës urbane dhe zonave rurale, si dhe qendrave të tjera.



11. TRANSPORTI I PA MOTORIZUAR, NË KËMBË DHE ME BIÇKLETA

Rrjeti i shtigjeve për këmbësore, biçikleta dhe hapësira publike duhet t'i kushtohet një planifikim i detajuar sipas modelit multimodal (avancim i transportit) dhe ndërlidhjes përmes hapësirave publike, parqeve dhe shtigjeve gjithashtu t'i kushtohet rendësi edhe lëvizjes së personave me nevoja të kufizuara. Vitet e fundit ju është dhënë një rëndësi e veçantë shtigjeve për çiklizëm, ku janë ndarë projekte për rregullimin e shtigjeve për biçikleta. Në vijim do të paraqesim rrugët e çiklizmit që kanë përfunduar dhe ato të cilat janë duke u punuar dhe që janë planifikuar të kryhen për periudhën në vijim.

Rrugët e përfunduara:

- 780 m rruga "Skënderbeu" në qytet, ana perëndimore;
- 1500 m rruga "Adem Jashari" deri në Berivojcë ana perëndimore;
- 770 m rruga për te liqeni i Rubocit;
- 900 m rruga Artana në Busavatë.

Në total të përfunduara janë 3950 m shtigje për çiklizëm.

Rrugët tjera që janë në procedura dhe të planifikuara me buxhet të ndarë për periudhën vijuese:

- 780 m rruga "Skënderbeu", ana lindore;
- 390 m rruga "Ramadan Kastrati" në Kamenicë;
- 1050 m rruga "Tahir Sinani" në Kamenicë;
- 900 m rruga "Sylë Zarinca" në Kamenicë;
- 175 m aksi i rrugës "Sylë Zarinca (te udhëkryqi për Strezoc) deri te rrethi në qendër;
- 1850 m rruga "Hasan Prishtina" në Kamenicë dhe Ruboc;
- 920 m vazhdimi i rrugës te liqeni i Rubocit;
- 1500 m rruga "Adem Jashari" , ana lindore;
- 220 m rruga "Vëllezërit Bytyqi" deri te rruga "Nëna Terezë" në Kamenicë.

Në total rrugë për çiklizëm që janë në procedura dhe të planifikuara me buxhet të ndarë janë 7785 m. Ndërsa totali i rrugëve ekzistuese dhe të tjera të çiklizmit është 11735 m.

12. PARKINGJET

Në përgjithësi në komunën e Kamenicës parkimi nuk është një problem i theksuar, përveç sezonit të verës kur kemi një ardhje të madhe të bashkatdhetarëve nga diaspora, por në këtë kohë kemi bërë edhe zgjidhje tjera, ku rrugën Nëna Terezë e kemi bërë njëkahëshe në mënyrë që në njërin anë të kemi hapësirë për parkimin e automjeteve. Numri i përgjithshëm i vend parkingjeve publike në qytet është 20 vende, ku i kemi 946 vende për parkim. Gjithashtu i kemi edhe 68 vende për Taxi. Numri i parkingjeve në parkime për persona me aftësi të kufizuara është 22 vende. Pasi veç tani kemi themeluar edhe NPL "Dardana" Sh.A, planifikojmë që në të ardhmet të gjitha parkingjet publike në qytet ti japim nën menaxhim kësaj ndërmarrje.

13. ZHVILLIMI INFRASTRUKTURËS

Infrastruktura është njëra ndër segmentet bazike për zhvillimin e kësaj hapësire e cila ndikon direkt në përmbushjen e objektivave të parashikuara në të gjitha fushat. Këtu shihet nevoja për lidhjen me autostradën e Gjilanit e cila është planifikuar të përfundojë në këtë vit. Ndërlidhja e kësaj rruge do të ndikonte jashtë zakonisht shumë edhe në zhvillimin e bizneseve në komunën e Kamenicës. Gjithashtu

këtë vit do të bëhet edhe asfaltimi i shumë rrugëve në vendet rurale sidomos ndërtimi i rrugëve në zonat kufitare dhe malore, përmirësimi i rrugëve ekzistuese dhe shtigjeve të ecjes dhe koordinimit me pikat ndërkufitare.

Me arritjen e zhvillimit efikas të infrastrukturës do të thotë jo vetëm mundësia e një qarkullimi të lirë dhe furnizimi të kërkuar, por edhe arritja e një ambienti të pastër pa ndotje me menaxhimin e duhur të mbeturinave, ngritjen e standardit me garantimin e energjisë elektrike duke stimuluar energjinë e ripërtëritëshme dhe një zhvillimi të integruar të arrihet kualiteti i një jete me standardet më të larta ku zënë vend edhe sistemi teknologjik i avancuar i cili e kategorizon në të ardhmen qytetin e Kamenicës

14. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

Gjendja ekzistuese e trafikut në komunën e Kamenicës është vlerësuar jo e mirë. Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese në trafik janë trajtuar problemet kryesore nga fusha e trafikut dhe transportit në komunën e Kamenicës. Nga analiza e bërë, si dhe bazuar edhe në vërtetimet e pjesshme të bëra në terren nga institucionet Komunale, është evidentuar se disa pjesë të rrugëve kanë nevojë për mirëmbajtje dhe rehabilitim. Psh. Rruga Hogosht – Lisockë, është një rrugë mjaftë e rëndësishme për banorët e kësaj ane, por mirëmbajtja e saj sidomos në sezonin e dimrit na shkakton probleme bukur të mëdha në mirëmbajtje.

Këto rrugë për momentin mirëmbahen me fonde të Komunës ku ato fonde janë të kufizuara, sidomos mirëmbajtja e sinjalizimit të rrugëve. Në vitin 2024 komuna i ka rritur fondet për realizimin e sinjalizimit dhe mendojmë se do të kemi edhe përmirësim të kushteve sinjalistike, ku do të ndikoj edhe në zvogëlimin e rasteve të aksidenteve dhe zvogëlimin e sigurisë rrugore në përgjithësi.

15. SIGURIA NË TRAFIK

Duke pasur para sysh që të kemi të dhëna sa më të sakta lidhur me gjendjen ekzistuese të sigurisë në Komunën e Kamenicës kemi kërkuar të dhëna nga policia e Kosovës për të na ofruar të dhënat për numrin e aksidenteve, pasojat dhe faktorët të cilët kanë shkaktuar aksidente, për periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2023. Prandaj, burimi i statistikave të prezantuara në këtë kapitull është siguruar nga policia e Kosovës, trafiku regjional i komunikacionit në Gjilan dhe stacioni policor në Kamenicë. Në Bazë të statistikave dhe analizave të marra nga policia e Kosovës, aksidentet me fatalitet dhe aksidentet me lëndime trupore kanë ndodhur më së shumti në rrugët Nacionale në akset rrugore:

- Novosellë - Rogaqicë – Hodonoc;
- Kamenicë - Berivojëçë - Koretin - Topanicë si dhe
- Kamenicë - Busavtë.

Ndërsa aksidentet me dëme të vogla materiale kanë ndodhur në të gjithë zonën e përgjegjësisë të Komunës së Kamenicës.

Këto të dhëna do të paraqesim në mënyrë tabelore në tabelën në vijim.

Nr.	Lloji i aksidentit	2019	2020	2021	2022	2023	Totali
1	Aksidente me fatalitet	1	2	1	1	2	7
2	Aksidente me lëndime trupore	55	41	64	60	51	271
3	Aksidente me dëme materiale	28	23	46	43	51	191
4	Persona të lënduar	78	65	105	125	92	465
5	Persona të vdekur	1	2	1	1	3	8
	TOTALI	163	133	217	230	199	942

16. SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL

Gjendja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në komunën e Kamenicës nuk është në nivel të kënaqshëm, duke pasur para sysh se komuna e Kamenicës ka një territor jashtëzakonisht të zgjeruar dhe nevojat për sinjalizimin përkatës janë të mëdha. Është e nevojshme që sinjalizimi të zgjerohet nëpër çdo rrugë lokale si në pjesën urbane ashtu edhe nëpër lokalitete tjera. Në vitin 2024 kemi planifikuar një buxhet më të madh për sinjalizim dhe presim që brenda një periudhe dy, tri vjeçare sinjalizimi të jetë në nivelin e duhur.

17. TRAFIKU PËR KËMBËSORË

Në qytetin e Kamenicës, sipërfaqet për lëvizje të këmbësorëve janë relativisht të kënaqshme. Trotuaret shtrihen përgjatë rrugës kryesore në të dy anët e rrugës dhe janë të ndara fizikisht nga pjesa e rrugës në të cilën lëvizin automjetet dhe mundësojnë lëvizje të lirë dhe të sigurt.

Zona më e frekuentuar e qendrës së qytetit është me gjerësi të mjaftueshme dhe në sipërfaqet e dedikuara për këmbësorë mundësohen lëvizje për këmbësorë. Gjithashtu edhe shtigjet për çiklistë janë të shenjëzuara dhe të përshtatshme për lëvizje me biçikletë. Me zgjerimin e qendrës së qytetit ju ka dhënë prioritet nga Komuna shtigjeve për çiklistë, ku do të kemi zgjerim të rrjetit të çiklizmit.

18. TRAFIKU PËR ÇIKLISTË

Qytetarët e Kamenicës janë të favorizuar nga terreni i rrafshët i qytetit dhe shtrirja e madhe e këtij terreni në drejtim të lokaliteteve përreth. Por, përkundër këtij terreni mjaft të përshtatshëm për zhvillimin e çiklizmit, një formë e tillë e lëvizjes nuk është promovuar sa duhet. Në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal që është duke u hartuar janë paraparë shtigjet të reja për çiklistë. Pas përfundimit të punëve të cilat janë planifikuar të kryhen shtigjet për çiklistë në totalë janë rreth 12 km rrugë për çiklizëm.

SHTIGJET E ÇIKLIZMIT NË KOMUNËN E KAMENICËS



LEGJENDA

- Komuna
- Zonat_Kadastrale_të_Dardanes
- Staza Dikikilstve

1 centimetër = 200 metër

19. TRANSPORTI KOLEKTIV (PUBLIKO-PRIVAT)

Pas viti 1999, në komunën e Kamenicës transporti publik ishte organizuar përmes kompanisë publike për transportin publik, me ato mjete që kishin mbetur nga kompania transportuese "Kosovatrans" deri në privatizimin e kësaj kompanie, pastaj në mënyrë graduale filluan që të operojnë edhe transportuesit privat. Sot në komunën e Kamenicës operojnë tetë kompani të transportit privat, të cilat e mbulojnë territorin e Komunës së Kamenicës, por që në disa lokalitete më të vogla transporti kryhet edhe auto kombi. Operatorët transportues privat respektojnë linjat e caktuara duke respektuar edhe orarin i cili paraprakisht është i publikuar.

Linjat brenda territorit të komunës janë:

- Kamenicë - Strezoc - Krilevë,
- Kamenicë - Topanicë,
- Kamenicë - Crep - Rogaqicë - Shipashnicë e Epërme - Hogosht,
- Kamenicë - Kopernicë - Hogosht,
- Kamenicë - Crep - Katushnicë - Karaqevë e Epërme,
- Kamenicë - Busavatë - Jabukovik,
- Kamenicë - Tugjee - Laku i pusave,
- Karaqevë e Epërme - Rogaqicë,
- Rogaqicë - Lagja e Behajve,
- Muqiverc - Krenidell,
- Kamenicë - në të gjitha lagjet e qytetit (transporti bëhet për nxënësit me auto kombi).
Në të gjitha këto linja, transporti bëhet edhe anasjelltas nga lokaliteti i shënuar në Kamenicë.

Linjat jashtë territorit të komunës janë:

- Kamenicë - Gjilan,
- Kamenicë - Gjilan - Prishtinë.

Linjë e rregullt ditore është edhe në relacionin:

- Kamenicë - Tiranë dhe anasjelltas.

Përveq linjave të rregullta, gjatë sezonit të verës kemi edhe linja tjera ditore për pushime verore në shumë qytete të Shqipërisë dhe në Malin e Zi, në relacionet:

- Kamenicë - Durrës,
- Kamenicë - Shëngjin,
- Kamenicë - Velipojë,
- Kamenicë - Vlorë - Sarandë,
- Kamenicë - Ulqin.

Transporti me autobus organizohet në disa forma dhe atë: transport ndërkombëtar, transport ndër urban dhe transport urbano-periferik.

Këto kategori janë të ndara edhe sipas menaxhimit, ku transporti ndërkombëtar dhe ndër urban menaxhohet nga Ministria e Infrastrukturës, kurse transporti urbano-periferik menaxhohet nga Komuna.

20. NGARKESA E TRAFIKUT

Për nevoja praktike janë të rëndësishme së veçantë karakteristikat e mospërputhshmërisë kohore të qarkullimit të automjeteve në periudha të ndryshme kohore. Periudha dhe zgjatja e numërimit varet nga qëllimet dhe mënyra e planifikimit. Rezultatet më të mira do të ishin kur numërimi të bëhet përmes numëruesve automatik, në periudha të gjata kohore (12 ose 24 orë në tërësi). Në mungesë të kohës dhe kufizimeve të tjera, për nevoja të ngarkesës së trafikut në komunën e Kamenicës është nuk është bërë numërimi, andaj edhe nuk ka të dhëna të sakta të cilat do të na japin një të dhënë reale.

21. INFRASTRUKTURA RRUGORE PËR PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Një sfidë e vazhdueshme që e vështirëson gjendjen faktike në terren për personat me nevoja të veçanta është mungesa e infrastrukturës së nevojshme për këtë kategori. Meqenëse Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka nxjerrë një udhëzim administrativ me anë të cilit obligohet rregullimi i kushteve teknike dhe mënyra e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me nevoja të veçanta. Andaj, Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe në partneritet me organizatat përkatëse për persona me nevoja të veçanta, duhet të marrin masat adekuate në përshtatje me kriteret teknike në mënyrë që të gjitha vendkalimet në rrugë dhe vendkalimet për këmbësorë, t'u mundësojnë qasje edhe personave me nevoja të veçanta.

Në projekt e ardhshme duhet të kenë në konsideratë këto prioritete:

- Qasja e lirë dhe e Sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, në punë, në shkollë, objektet e rëndësishme të veçantë, shërbimet e nevojshme ditore, etj.
- Siguria në trafik: qytetarët me nevoja ndryshe duhet të ndihen plotësisht të sigurt gjatë lëvizjes në hapësirat publike, rrugë, sheshe, parqe, vende rekreative, etj.
- Ruajtja e ambientit: zhvillimi dhe promovimi i lëvizjeve të pa motorizuara do të ndikojë në uljen e shkallës së motorizimit dhe mbrojtjen e ambientit.
- Shëndeti dhe komoditeti i qytetarëve me nevoja të veçanta.

22. SIGURIA NË TRAFIK NË AFËRSI TË SHKOLLAVE

Siguria në trafik në përgjithësi dhe siguria e nxënësve në afërsi të shkollave në veçanti ka ngjallur shqetësim publik dhe është vlerësuar njëra prej brengave kryesore në komunën e Kamenicës. Me qëllim të rritjes së sigurisë në afërsi të shkollave, ku janë rrugët lokale, në kuadër të këtij plani përveç sinjalizimit horizontal dhe vertikal janë paraparë edhe metodat fizike për kontrollin e trafikut, përkatësisht pengesat fizike- ngadalësuesit e shpejtësisë të cilat ndikojnë në qetësimin e trafikut. Me nocionin metoda fizike për kontrollin e trafikut nënkuptojnë të gjitha ato procedura të cilat në thelb janë veprime të trafikut dhe të cilat ndikojnë në sjelljen e drejtuesve të automjeteve. Ato përfshijnë edhe qetësimin e trafikut në udhëkryqe dhe në akse rrugore, si dhe përparësitë për këmbësorë dhe çiklistë.

Masat më të shpeshta për zvogëlimin e shpejtësisë dhe rritjen e sigurisë në trafik janë masat për qetësimin e trafikut. Në parim, qetësimi i trafikut është kombinim i një numri më të madh masash që kanë për qëllim zvogëlimin e efekteve negative nga përdorimi i automjeteve motorike dhe çojnë deri te ndryshimi i sjelljes së ngasësve dhe zvogëlimi i shpejtësisë maksimale të lëvizjes në trafik, duke përfshirë këto masa për qetësimin e trafikut:

- zvogëlimi i shpejtësisë në afërsi të shkollave dhe në zonat tjera të rëndësishme;
- krijimi i kushteve në rrugë për paralajmërimin dhe detyrimin e ngasësve që të ngasin në mënyrë të qetë dhe me kujdes;
- përmirësimin dhe mbjellja e gjelbërimit në dy anët e rrugëve, përmirësimi i mjedisit;
- zvogëlimin e numrit aksidenteve të trafikut.


23. INFRASTRUKTURA MODERNE, QENDRA E QYTETIT

Për ndërtimin e qendrës së qytetit të Kamenicës është parapa përfundimi i projektit të bulevardit në qytet ku bulevardi është shndërruar në janë shëtitore e pajisur me të gjithë infrastrukturën moderne me hapësira të gjelbra, drunjë dekorativ, kënde të lojnavë, teatri veror dhe të tjera. Në këtë pjesë po ashtu nuk ka qarkullim të automjeteve dhe lëvizja bëhet vetëm në këmbë. Në pjesët jashtë bulevardit janë edhe parkingjet publike, ku qytetarët mundë ti parkojnë automjetet e tyre jo shumë larg bulevardit. Gjatë sezoni të verës e gjithë hapësira publike para lokaleve afariste që merren me gastronomi është e planifikuar të ju jepet në shërbim, kështu që qytetarët të kenë mundësi për tu freskuar dhe argëtuar.



Qendra e qytetit, konkretisht bulevardi është i lidhur në të gjitha anët me rrugë tjera të cilat lidhen me rrugët kryesore që shkojnë në vende tjera.

Për pos bulevardit të qytetit është me rëndësi se jo shumë larg është i vendosur edhe parku i qytetit ku qytetarët e kalojnë kohën e lirë. Parku është i rregulluar mjaftë mirë, ku përveç gjelbërimit janë edhe të gjitha kushtet tjera për argëtim duke e përfshi edhe këndin e lojërave për fëmijë, ulëset e ndryshme afër hapësirave të gjelbra, drunjtë dekorativ, si dhe fusha e basketbollit ku të rinjtë dhe të rejat mundë të argëtohen duke shijuar një ambient shumë të mirë.



Parku i qytetit në qendër

24. KRIJIMI I SHTIGJEVE PËR ÇIKLISTË

Plani për rritjen e përdoruesve të biçikletave në qytet synon zvogëlimin e trafikut, rritjen e cilësisë së ajrit dhe përmirësimin e shëndetit publik. Kjo do të arrihet duke krijuar shtigje të reja për çiklistë, duke përmirësuar sigurinë e çiklizmit dhe institucionalizimin e çiklizmit.

Një pjesë simbolike e qytetarëve të Kamenicës lëvizin rregullisht me mjete ekologjike transporti si: ecja në këmbë dhe ngasja e biçikletave. Prandaj, me qëllim të promovimit dhe avancimit të kësaj forme të lëvizjes, rekomandohet:

- Finalizimi i projekteve të planifikuara që kanë të bëjnë me krijimin e shtigjeve për çiklistë.
- krijimi i vend parkimeve të biçikletave më pranë akseve kryesore të shtigjeve për çiklistë, si dhe pranë objekteve të rëndësisë së veçantë, duke siguruar përdorimin e disa llojeve të transportit.
- Lidhjen e objekteve të trashëgimisë kulturore me shtigje të çiklistëve
- krijimi i programeve për edukimin e fëmijëve dhe të rinjve për përdorimin e biçikletave, si një mënyrë e shëndetshme dhe argëtuese udhëtimit.
- krijimi i shtigjeve për çiklistë siç është zona e lumit dhe shtigje tjera për rrugët e malësisë.

25. MIRËMBATJA

Është e rëndësisë së veçantë që komuna të bëjë edhe planifikimin e duhur buxhetor në lidhje me mirëmbajtjen projekteve të propozuara, por edhe të investimeve të mëhershme që janë bërë në fushën e transportit rrugor. Në mënyrë që të arrihet kjo, komuna duhet që patjetër ta bëjë inventarizimin e aseteve në fushën e infrastrukturës rrugore si dhe të ketë një data bazë të saktë të digjitalizuar duke krijuar edhe këto kushte:

- Krijimi i një sistemi për këmbësorët, një sistemi të sigurt të përshtatshëm dhe të integruar me të gjitha aspektet e tjera të sistemit të transportit.
- krijimi i lehtësirave për lëvizje të këmbësorëve duke u dhënë këmbësorëve të njëjtin rëndësi me llojet e tjera të transportit gjatë shpërndarjes së hapësirës së përbashkët publike.
- përmirësimi i infrastrukturës së këmbësorëve që përfshinë, ndërhyrjen nëpër udhëkryqe për t'i bërë më të sigurt për kalimtarët.
- përmirësimi i trotuareve dhe pajisja e tyre me ndriçim,
- përmirësimi dhe plotësimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal në vendkalimet për këmbësorë, përpilimi i një udhërrëfyesi dhe hartave për ecje në këmbë.
- Sigurimi i hartave për vendet me interes për t'u vizituar në tërë komunën e Kamenicës, organizimi i ditëve të veçanta, këtu përfshihet organizimi i "Ditës pa automjete të motorizuara"

25. PLANI I MONITORIMIT

Plani i monitorimit është një dokument me të cilin monitorohet realizimi i masave të propozuara në kuadër të planit. Për përcjelljen e realizimit të planit është përgjegjës Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit. Ky plan për komunën e Kamenicës është një dokument strategjik dhe realizimi i tij varet nga përshtatja dhe dinamika e realizimit të planeve tjera në nivel komunal në përputhshmëri me PZHK-ës dhe hartat zonale si dhe duke pasur parasysh faktin se monitorimi dhe realizimi e këtij plani është e nevojshme mbështetja jo vetëm nga drejtoritë e tjera në nivel komunal, por edhe nga niveli qendror.

Me miratimin e këtij plani, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, së paku një herë brenda vitit i raporton Kuvendit Komunal lidhur me realizimin e masave të parapara për periudhën e caktuar. Gjithashtu është e nevojshme që zyrtari nga kjo drejtori i cili merret me planin e transportit të marr pjesë në takimet e këshillit komunal për siguri në bashkësi ku do të japin informata të sakta lidhur me sigurinë në komunikacion.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.251 dt. 20.06.2024

Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 paragrafi 1, shkronja g) dhe neni 40 par. 1 të Ligjit Nr.03/L.-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 12 paragrafi 1.6 dhe neni 31 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Regullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjine e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të tjera, dhe neni 38 paragrafi 38.1, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit 01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më 21.06.2024, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

(Per miratimin e Raportit Përfundimtar Sh.02.nr.18818 të datës 10.06.2024, i hartuar nga Komisioni Profesional Komunal Sh.02.nr.14580 i dates 25.04.2023 i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.nr.24967 i dates 28.07.2023, mbi versimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore gjegjësisht Breshëri në Pemishtën e z.Shkëlzen Mehmeti, dëmet e shkaktuara nga Breshëri që ka rënë me datën 08.05.2024, në fshatin Koretin të Komunes se Kamenicës, në vlerë totale prej 8,799.12 Euro)

1. Me këtë vendim të nxjerrë nga Kuvendi Komunal do të Miratohet Raporti Përfundimtar Sh.02.Nr.18818 , të datës 10.06.2024, hartuar nga Komisioni Profesional Komunal Sh.02.Nr.14580, të datës 25.04.2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.Nr.24967, i datës 28.07.2023 mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Breshëri i rënë i datës 08.05.2024 në fshatin Koretin të Komunës së Kamenicës, në vlerë totale prej 8,799.12 Euro.
2. Me miratimin e këtij vendimi miratohet Raporti i Dëmeve i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, Raporti përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim të Komisioneve paraprake të emëruara nga Kryetari i Komunes.
3. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Kryetari i Komunes në bashkëpunim me Komisionin Profesional Komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Breshëri.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Ekonomik, Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe QSHQ- arkivi.

Kryetar i Komunës


Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËME
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 20140
U. Br.

Nr. i faq. 2 Data: 21/06
Br. str. KAMENICË/A Datum: 2024

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.248 dt.20.06.2024

Bazuar në nenet 11, 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), Në bazë të nenit 13 dhe 15 të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kamenicë Nr.38349 të datës 02.12.2016, në përputhje me udhëzimin administrativ (Shëndetësi) nr.04/2020, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më 21.06.2024 sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër

1. Miratohet Vendimi për mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër, në Parcelat Kadastrale P-71107041-01289-0, P-71107041-01290-0 të cilat gjenden në vendin e quajtur "Kamenicë" pronë shoqërore Kuvendi i Komunës së Kamenicës, zona kadastrale Kamenicë.
2. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat kurse Mbikqyrjen për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës.
3. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat; dhe
- Arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Arsyetim

- 1. Mungesa e mjekut:** Aktualisht, QMF Qendër nuk ka në dispozicion një mjek të licencuar për të ofruar shërbime mjekësore të domosdoshme për pacientët.
- 2. Mungesa e infrastrukturës:** Objektet dhe pajisjet mjekësore në QMF Qendër janë të papërshtatshme dhe nuk plotësojnë standardet e kërkuara për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore.
- 3. Largësia e QKMF-së nga QMF Qendër:** Distanca ndërmjet QKMF-së dhe QMF Qendër është më pak se 5 kilometra, çka e bën të panevojshme ekzistencën e dy qendrave të afërta shëndetësore.
- 4. Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) nr. 04/2020:** Sipas këtij udhëzimi, infermierët nuk kanë të drejtë të japin terapi parenterale pa prezencën e mjekut. Duke qenë se QMF Qendër nuk ka mjek, kjo qendër nuk i plotëson kriteret për kryerjen e shërbimeve shëndetësore sipas udhëzimeve dhe ligjeve në fuqi.

Në bazë të kompetencave të dhëna nga statuti i QKMF-së dhe udhëzimet administrative, propozoj mbylljen e QMF Qendër për shkaqet e sipërpërmendura.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PER SHERBIM TE QYTETIT
CENTAR ZA USLUGU GRABANA

Sh. 02 Nr. 20151
U. Dr.

Nr. i faq. 2 Data: 21/06
Bros. Denum:

KAMENICE/A Komuna e Kamenicës

Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.249 dt. 20.06.2024

Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 paragrafi 1, shkronja g) dhe neni 40 par. 1 të Ligjit Nr.03/L.-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 12 paragrafi 1.6 dhe neni 31 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Regullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjine e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të tjera, dhe neni 38 paragrafi 38.1, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit 01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më 21.06.2024, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

(Per miratimin e Raportit Përfundimtar Sh.02.nr.18821 të datës 10.06.2024, i hartuar nga Komisioni Profesional Komunal Sh.02.nr.14580 i dates 25.04.2023 i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.nr.24967 i dates 28.07.2023, mbi versimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqësit natyrore gjegjësisht Vërshimet nga Shiu në Fermën e z.Ardian Kureshi, dëmet e shkaktuara nga Vërshimet nga Shiu që ka rënë me datën 08.05.2024, në fshatin Koretin të Komunes se Kamenicës, ne vlerë totale prej 4,731.00 Euro)


1. Me këtë vendim të nxjerrë nga Kuvendi Komunal do të Miratohet Raporti Përfundimtar Sh.02.Nr.18821 , të datës 10.06.2024, hartuar nga Komisioni Profesional Komunal Sh.02.Nr.14580, të datës 25.04.2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.Nr.24967, i datës 28.07.2023 mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Vërshimet nga Shiu i rënë i datës 08.05.2024 në fshatin Koretin të Komunës së Kamenicës, në vlerë totale prej 4,731.00 Euro.
2. Me miratimin e këtij vendimi miratohet Raporti i Dëmeve i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, Raporti përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim të Komisioneve paraprake të emëruara nga Kryetari i Komunes.
3. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Kryetari i Komunes në bashkëpunim me Komisionin Profesional Komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Breshëri.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Ekonomik, Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe QSHQ- arkivi.


Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.250 dt. 20.06.2024

Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 paragrafi 1, shkronja g) dhe neni 40 par. 1 të Ligjit Nr.03/L.-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 12 paragrafi 1.6 dhe neni 31 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Regullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjine e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të tjera, dhe neni 38 paragrafi 38.1, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit 01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më 21.06.2024, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

(Per miratimin e Raportit Përfundimtar Sh.02.nr.18820 të datës 10.06.2024, i hartuar nga Komisioni Profesional Komunal Sh.02.nr.14580 i dates 25.04.2023 i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.nr.24967 i dates 28.07.2023, mbi versimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore gjegjësisht Erërave të forta në Serrën e z.Benjamin Rrudhani, dëmet e shkaktuara nga Erërat e Forta që ka ndodhur me datën 01.04.2024, në fshatin Rogaçicë të Komunës së Kamenicës, në vlerë totale prej 624.50 Euro)

1. Me këtë vendim të nxjerrë nga Kuvendi Komunal do të Miratohet Raporti Përfundimtar Sh.02.nr.18820 të datës 10.06.2024, hartuar nga Komisioni Profesional Komunal Sh.02.Nr.14580, të datës 25.04.2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.Nr.24967, i datës 28.07.2023 mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Erërat të datës 01.04.2024 në fshatin Rogaçicë të Komunës së Kamenicës, në vlerë totale prej 624.50 Euro.
2. Me miratimin e këtij vendimi miratohet Raporti i Dëmeve i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, Raporti përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim të Komisioneve paraprake të emëruara nga Kryetari i Komunes.
3. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Kryetari i Komunes në bashkëpunim me Komisionin Profesional Komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Erërat.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Ekonomik, Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe QSHQ- arkivi.

Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj

